

FRIKA PREJ  
XHEHENNEMIT



DHE MALLI PËR  
XHENNETIN

**Frika prej  
Xhehennemit**

**dhe**

**Malli për  
Xhennetin**



Autor: Abdurrahman Ibn Rexhebi  
Abdul Uahid el-Magribi

Përktheu: Abdurrahim Balla

Kopertina: Rexhep Dajçi

Shtypi: Graf Ing

Tirazhi: 5000 copë

Boton: Rinia Islame Prizren

[www.riniaislame.com](http://www.riniaislame.com)

*Falënderojmë të gjithë ata që mundësuan botimin e këtij libri!*

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

## Parathënie

Falënderimi i takon vetëm Allahut, vetëm Atë falënderojmë! I kërkojmë ndihmë, falje dhe mbrojtje nga të këqijat e vetëve tona e nga të këqijat e punëve tona. Atë që e udhëzon Allahu nuk ka kush e humb dhe atë që Ai e humb nuk ka kush e udhëzon! Dëshmoj se nuk ka të adhuruar tjetër veç Allahut dhe Muhamedi është rob dhe i dërguar i Tij.

**"O ju që keni besuar! Kini frikë Allahun ashtu siç duhet pasur frikë Ai dhe mos vdisni ndryshe veçse duke qenë muslimanë". (Ali Imran: 102)**

**"O njerëz! Jini të bindur (dhe përmbushni detyrimet) ndaj Zotit tuaj, i Cili ju krijoi prej një veteje (Ademit) dhe nga ajo, krijoi palën (bashkëshorten) e saj. Dhe nga ata të dy, Ai krijoi burra dhe gra të shumtë. Kijeni frikë Allahun, nëpërmjet të Cilit ju kërkonit të drejtat e ndërsjella, dhe mos i ndërprisni marrëdhëniet me të afërmit. Allahu është Vëzhgues mbi ju". (En-Nisa: 1)**

**"O ju që keni besuar! Kijeni frikë Allahun dhe flisni fjalë të drejta. Ai do t'ju drejtojë ju tek veprat e mira dhe do t'ju falë juve gjynahet tuaja. Kushdo që i bindet Allahut dhe të Dërguarit të Tij, me të vërtetë që ka arritur fitore të madhe". (El-Ahzab:70-71)**

Fjalët më të vërteta janë fjalët e Allahut dhe udhëzimi më i mirë është udhëzimi i Muhamedit (sal-lAllahu alejhi ue selem). Gjërat më të këqija janë gjërat e shpikura! Çdo shpikje është bidat, çdo bidat është humbje dhe çdo humbje të çon në zjarr!

Allahu i ka krijuar xhindet dhe njerëzit që ta adhurojnë Atë, ta njësojnë dhe t'i binden. E ka premtuar për atë që i bindet Xhennetin si mirësi prej Tij. Sikurse ka premtuar për atë që e kundërshton që do ta ndëshkojë me Zjarr si drejtësi prej Tij.

Duhet ditur se Xhenneti dhe Xhehennemi janë të krijuara tani. Argument për këtë është fjala e Allahut për Xhennetin: **"Është përgatitur për të devotshmit"**. (Ali Imran: 133)

E për Xhehennemin ka thënë: **"Është përgatitur për mosbesimtarët"**. (Ali Imran: 131)

**Në një hadith thuhet: "Allahu ka krijuar për Xhennetin banorë e i ka përgatitur ata që kur ishin në kurrizin e baballarëve të tyre e punët e banorëve të Xhennetit kanë për të vepruar. Gjithashtu ka krijuar për zjarrin banorë i ka përgatitur për të që kur ishin në kurrizin e baballarëve të tyre e ata punën e banorëve të zjarrit do kryejnë". (Transmeton Muslimi)**

Xhenneti është shpërblimi i miqve të Allahut të cilët i binden Atij dhe të dërguarit të Tij (sal-lAllahu alejhi ue selem). Xhehennemi është ndëshkimi i Allahut për armiqtë e Allahut të cilët e kundërshtojnë Allahun dhe të dërguarin e Tij (sal-lAllahu alejhi ue selem). Zoti yt nuk i bën padrejtësi askujt. Një sevab (shpërblim) është dhjetëfish e më shumë deri në shtatëqind fish e mbase edhe më shumë. Ndërsa gjynahu shkruhet vetëm një e po të dojë Allahu e fal edhe atë.

Shumicës së njerëzve nuk u ka hyrë besimi në Ahiret në brendësinë e zemrave të tyre. Argument për këtë është përgatitja e madhe që bëjnë ata për të nxehtin e verës dhe të ftohtin e dimrit dhe mospërgatitja e tyre për të nxehtin e Xhehennemit dhe të ftohtin e tij. Allahu na ruajt prej zjarrit dhe prej çdo fjale dhe punë që të çon atje.

Allahu i Madhëruar ka thënë në Kur'an: **“Tregoju robërve të Mi se Unë jam Falës, Mëshirues dhe se ndëshkimi Im është ndëshkim i rreptë”**. (El Hixhr: 49, 50)

Duket qartë që Allahu i Madhëruar dëshiron prej robërve të Tij që ata të kenë frikë prej madhështisë së Allahut, prej dënimit të Tij dhe shkaqeve që të çojnë atje dhe të kenë shpresë tek mëshira e Tij e gjerë. Ky është rregulli i Kur'anit.

Sa herë që përmendet frika përmendet me të edhe shpresa. Gjithashtu sa herë që përmendet Xhehennemi përmendet edhe Xhenneti, sepse frika dhe shpresa janë të pandashme nga njëra-tjetra.

Frika dhe shpresa janë dy adhurime të mëdha të zemrës pa të cilat njeriu nuk shkon dot tek Allahu I Madhëruar.

Mekhul Ed-dimeshkij ka thënë: "Kush e adhuron Allahun vetëm me frikë ai është harurij (hauarixh). Ai që e adhuron vetëm me shpresë është murxhi, kush e adhuron Allahun vetëm me dashuri është zindik (munafik) ndërsa kush e adhuron Atë me frikë, shpresë dhe dashuri ai është njësues".

Prandaj nuk është e drejtë t'u flasësh njerëzve vetëm për mëshirën dhe Xhennetin sidomos në kohën e sotme ku ka mbizotëruar shpresa ndërsa frika është harruar fare. Gjë e cila e çon njeriun në shkatërrim sepse njeriu që nuk ka frikë Allahun e ka të thjeshtë të bjerë në gjynahe sidomos kur mendon se Allahu është vetëm Falës dhe Mëshirues. Por harron se ndëshkimi i Tij është shumë i rëndë gjithashtu.

Hasen el-Basriu ka thënë: "Nuk e ka frikë Allahun vetëm se besimtari dhe nuk është i sigurt prej ndëshkimit të Tij vetëm se munafiku".

Gjithashtu Allahu i Madhëruar kur i ka lavdëruar dijetarët në Kur'an ka thënë: **"Robërit që e kanë frikë Allahun (siç duhet) janë vetëm dijetarët"**. Nuk ka thënë : "Robërit që e kanë shpresë" por ka thënë "Ata që e kanë frikë" sepse frika vjen nga njohja e Allahut të Madhëruar. Edhe pse frika pa shpresë nuk quhet frikë dhe as shpresa pa frikë nuk quhet shpresë. Ato të dyja janë të pandashme nga njëra-tjetra por frika është ajo që i veçon dijetarët që e njohin Allahu nga të tjerët të cilët kanë shpresë pa pasur frikë prej Allahut sepse njerëzit që kanë vetëm shpresë janë të guximshëm të zhyten në gjynahe dhe mendojnë vetëm për Xhennetin ndërsa Xhehennemin nuk e përmendin fare ose e përmendin shumë pak.



Për këtë arsye u përpoqa të përgatis këtë material që flet për frikën nga Allahu, për ndëshkimin e Tij dhe për shpresën tek Allahu dhe për Xhennetin e Tij sepse ato edhe në Kur'an dhe Sunnet kështu janë treguar. E dobia e vërtetë e tyre është kur ato janë së bashku frikë e shpresë. Në të kundërt vetëm frika pa shpresë quhet pesimizëm dhe shpresa pa frikë është mashtrim dhe ëndërr me sy hapur. Pesimizmi është cilësi e mosbesimtarëve siç e ka treguar Allahu në Kur'an dhe siguria prej ndëshkimit të Allahut është cilësi e njerëzve të shkatërruar në Ahiret. Allahu na ruajt prej të dyjave.

Gjatë kërkimit tim nuk ka gjetur një libër të vetëm që flet për të dyja, për këtë arsye e pashë të nevojshme të bashkoj dy librat në këtë material të cilat flasin për frikën, Xhehennemin, shpresën dhe Xhennetin. Kam treguar përshkrimin e zjarrit të cilin e kam marrë dhe përzgjedhur prej librit të Ibn Rexhebit - Allahu e mëshiroftë - me titull "**Frika prej Zjarrit**". I kam bashkangjitur këtij materiali një kasetë që flet për Xhennetin dhe mëshirën e Allahut në të cilën ka folur Abdul Uahid el-Magribi.

Këto dy materiale janë pjesët përbërëse të këtij libri. Së fundi lus Allahun e Madhëruar të na bëjë prej atyre që i frikësohen Allahut ashtu siç i takon madhësisë së Tij, të na bëjë prej atyre që shpresojnë tek mëshira e Tij e gjerë, të na ruajë prej Xhehennemit dhe të na bëjë prej banorëve të Xhennetit!  
Amin

*Përkthyesi*

**Përshkrimi i zjarrit  
të Xhehennemit  
dhe shkaqet që të  
çojnë tek ai**

Shkroi dijetari i njohur  
Abdurrahman Ibn Shihabuddin Ibn Rexheb



Falënderimi i takon Allahut, Zotit të botëve. Salavatet dhe paqja janë për Profetin tonë, Muhamedin, familjen dhe mbarë shokët e tij.

Zjarri është përshkruar në Kur'an dhe në Sunnetin e Profetit (sal-Allahu alejhi ue sel-lem) që njerëzit të ruhen prej tij dhe prej punëve që të çojnë atje. Prej tyre janë këto hadithe të cilat po i tregojmë më poshtë.

Në hadithin e saktë thuhet: "**Zjarri juaj është një e shtatëdhjeta e zjarrit të Xhehennemit**". (Mutefekun alejhi)

Në një hadith tjetër thuhet: "**Do sillen Xhehennemi atë Ditë. Ai ka shtatëdhjetë mijë frerë. Çdo fre e tërheqin shtatëdhjetë mijë melaike**". (Transmeton Muslimi)

Në një hadith tjetër thuhet: "**Disa njerëz i mbulon zjarri deri tek nyjat e këmbëve. Disa i mbulon deri tek gjunjët. Disa i mbulon deri tek beli. Disa i mbulon deri në fyt**". (Transmeton Muslimi)

Në një hadith tjetër thuhet: "**Ai që ka dënimin më të lehtë në Xhehennem është ai që ka një palë shapka prej zjarri prej të cilave i ziejnë trutë siç zien tenxherja. Ai mendon se askush nuk dënohet më shumë se ai, megjithëse ai ka dënimin më të lehtë në Xhehennem**". (Mutefekun alejhi)

Ushqimi i banorëve të Zjarrit është "**Edh-dharri'u**" është një pemë e cila ka arritur kulmin e nxehtësisë, hidhësisë dhe erës së keqe e kjo është ajo që quhet ndryshe pema e Zekumit ose mund të jetë diçka tjetër.

Gjithashtu ushqimi i tyre është edhe "**Gislini**" i cili është qelbi i banorëve të zjarrit. Allahu na ruajt.

Pija e banorëve të zjarrit është "El hamim" uji i nxehtë i cili ka arritur kulmin në nxehtësi. Kur u afrohet tek fytyrat e tyre ua pjek fytyrat e kur ta pinë ua këput zorrët. Allahu i Madhëruar ka thënë: "**E nëse kërkoni ujë u jepet ujë si vaj i keq i cili ua pjek fytyrat. Ah sa pije e keqe është kjo**". (El-Kehf: 29)

Gjithashtu ka thënë: "**U jepet për të pirë hamim (ujë i nxehtë) i cili ua këput zorrët cop-copa**". (Muhamed: 15)

Veshja e banorëve të zjarrit është Katrani, Hekuri dhe ata kanë rroba prej zjarri. Allahu na ruajt.

Allahu na ka paralajmëruar të ruhemi pre zjarrit aty ku thotë: "**Ju kam paralajmëruar prej zjarrit të vrullshëm**". (El-Lejl: 14) Dhe aty ku thotë: "Ruajuni prej zjarrit që është përgatitur për mosbesimtarët". (Ali Imran 131)

Shkaqet kryesore që të çojnë në Xhehennem janë: përgënjeshtrimi i fjalës së Allahut dhe të dërguarit të Tij me zemër dhe shkaku i dytë është mosbindja ndaj urdhrave të Allahut dhe të dërguarit të Tij (sal-lAllahu alejhi ue selem).

**"Ne na është shpallur se ndëshkimi është për atë që përgënjeshton dhe i kthen shpinën (urdhrave të Allahut)".** (Taha: 48)

Një prej shkaqeve që të ruajnë prej zjarrit është që t'i kërkosh Allahut mbrojtje prej tij dhe e qara prej frikës së Allahut. Gjithashtu edhe largimi prej punëve që të çojnë atje.

Profeti (sal-lAllahu alejhi ue selem) shpeshherë i kërkonte Allahut mbrojtje prej zjarrit dhe ka urdhëruar një besimtarin t'i kërkojë mbrojtje Allahut prej zjarrit në namaz e në raste të tjera.

Në shumë raste lutja që bënte Profeti (sal-lAllahu alejhi ue sel-lem) ishte: **"O Zot, na jep mirësi në dynja, mirësi në Ahiret dhe na ruajë nga dënimi i zjarrit"**. (Transmeton Buhariu nga Enesi radiAllahu anhu)

Të gjithë Profetët, siddikët (të drejtët), dëshmorët dhe njerëzit e mirë ishin të frikësuar nga zjarri dhe i frikësonin njerëzit prej tij.

Frika që është vaxhib është ajo frikë që të shtyn të kryesh detyrat dhe të ndalon nga haramet.

Disa selefë kur shikonin zjarrin e dynjasë trembeshim shumë dhe u ndryshonte ngjyra e fytyrës sepse Allahu ka thënë: "**Ne e kemi bërë atë (zjarrin e dynjasë) si përkujtim**". (El-Uakia: 73)

Disa prej tyre i ndaloi frika nga Xhehennemi prej gjumit. Disa prej tyre thoshin: Çuditëmi prej atij që kërkon Xhennetin si fle gjumë dhe çuditëmi prej atij që do t'ia mbathë prej zjarrit si fle gjumë?!

Disa prej tyre i ndaloi frika nga Xhehennemi të qeshurin. Disa prej tyre i kishin dhënë besën Allahu të mos qeshnin kurrë. Seid Ibn Xhubejri (Allahu e mëshiroftë) ka thënë: "Si të qesh kur Xhehennemi është ndezur, prangat janë varur dhe zebanijet po presin".

Disa prej selefëve frika nga Xhehennemi i shkaktoi sëmundje madje disa prej tyre vdiqën prej kësaj frike.

Allahu i Madhëruar ka thënë: "**Për atë që ka frikë qëndrimin para Zotit të Tij ka dy Xhennete**". (Er-Rahman: 46)

Profeti (sal-lAllahu alejhi ue sel-lem) ka thënë:  
*"Sikur ta dini atë që di unë, do qeshnit pak e do qanit shumë. Aty mbuluan kokat shokët e Profetit (sal-lAllahu alejhi ue sel-lem) e u dëgjohej zë nga e qara".* (Transmetonjné Buhariu dhe Muslimi)

Allahu e ka krijuar zjarrin për xhindet dhe njerëzit që e kundërshtojnë Atë e me ta do mbushet.

Allahu i Madhëruar ka thënë: **"Ne kemi krijuar për Xhehennemin shumë xhinde dhe njerëz"**. (El-A`raf: 179)  
Gjithashtu ka thënë: **"Është plotësuar fjala e Zotit tënd: Do ta mbush Xhehennemin plotë me xhinde dhe njerëz bashkërisht!"** (Hud 119)

E qara nga frika prej zjarrit të shpëton prej tij. Kërkimi mbrojtje Allahut prej zjarrit bën që Allahu të të ruajë prej tij. Në hadith tregohet se Profeti (sal-l Allahu alejhi ue sel-lem) ka thënë: **"Nuk hyn në zjarr ai që qan nga frika e Allahut deri sa të kthehet qumështi në gj"**. (Transmetonjné En-Nesaiu dhe Tirmidhiu dhe ka thënë: Hadithi është i saktë)

Gjithashtu ka thënë: **"Dy sy nuk i prek zjarri: Atë sy që qan nga frika e Allahut dhe atë sy që ruan në rrugën e Allahut"**. (Transmeton Tirmidhiu dhe ka thënë: Hadithi është i saktë)



Vendi i zjarrit është toka e shtatë e cila është shtresa më e poshtme e saj në Sixhxin në vendin më të ulët dhe më të ngushtë. Ndërsa Xhenneti është poshtë Arshit të Allahut. Krijesat sa më lartë të jenë aq më të gjera janë dhe sa më poshtë që të jenë aq më të ngushta janë. Xhenneti është në vendin më të lartë e më të gjerë. Ndërsa Xhehennemi është në vendin më të ulët e më të ngushtë. Allahu na ruajtë prej tij dhe prej punëve që të afrojnë tek ai!

Xhehennemi ka shtatë shtresa të cilat janë: **Xhehennem, Ledha, El-Hutameh, Es-Seirr, Sakarr, El-Xhehim dhe El-Haujeh.**

Thellësia e Xhehennemit është shtatëdhjetë vjet siç është treguar në hadithin që e transmeton Muslimi e të tjerë.

Portat e Xhehennemit janë të mbyllura për banorët që ndodhen në të. Allahu i Madhëruar ka thënë: "**Ata janë në zjarr të izoluar (Portat e tij janë mbyllura)**". (El-Beled: 20)

Portat e Xhehennemit janë të mbyllura para se të hyjnë banorët e tij në të. "**Derisa kur të vijnë u hapen portat e tij**". (Ez-Zumer 71)

Zjarrin e rrethojnë mure prej zjarri. Allahu i Madhëruar ka thënë: "**Ne kemi përgatitur për mizorët zjarr të cilin e rrethojnë mure prej zjarri**". (El Kehf: 29)

Xhehennemi është i zi dhe banorët e tij janë të zinj. E çdo gjë në të është e zezë. Argument që banorët e tij janë të zinj është fjala e Allahut të Madhëruar: **"Fytyrat e tyre (duken) sikur janë mbuluar me copa nate pis. Këta janë banorët e zjarrit. Ata janë të përjetshëm në të"**. (Junus: 27) Gjithashtu ka thënë: **"Atë ditë do zbardhen fytyra e do nxihen fytyra"**. (Ali Imran: 106)

Është transmetuar në hadithe të sakta se disa besimtarë mëkatarë digjen në zjarr derisa bëhen qymyr.

Zjarri është shumë i nxehtë. Allahu i Madhëruar ka thënë: **"Ata thanë: Mos ikni në të nxehtë. Thuaj: Zjarri i Xhehenemit është më i nxehtë sikur të kuptonin"**. (Et-Teubeh 81)

Në librin e Buhariut dhe Muslimit tregohet hadithi se: **"Zjarri u ankua tek Allahu dhe tha: Jam duke ngrënë veten time. Prandaj iu dha leje të shfryjë dy herë në vit. Një herë në dimër dhe një herë në verë. Për këtë arsye nxehtësia më e madhe gjë jeni është prej tij dhe ftohtësia më e madhe që jeni është prej tij"**. Gjithashtu në një hadith tjetër thuhet: **"Zjarri juaj që ndizni është një e shtatëdhjeta e zjarrit të Xhehenemit"**.

Xhehennemi ndizet çdo ditë në mesin e ditës e nganjëherë ndizet edhe në kohë të tjera. Gjithashtu do ndizet edhe ditën e Gjykimit. Allahu i Madhëruar ka thënë: **"E kur të ndizet Xhehimi (zjarri)"**. (Et-Tekuir 12) D.m.th. rindizet herë pas herë për shkak të gjynaheve të bijve të Ademit të cilat shkaktojnë zemërimin e Allahut kundrejt tyre e për këtë shkak shtohet flaka e tij. Allahu na ruajt prej dënimit të Tij! Gjithashtu do ndizet edhe më shumë kur të hyjnë banorët e tij në të. Allahu i Madhëruar ka thënë: **"Sa herë që shuhet Ne u shtojmë zjarrin"**. (El-Isra: 97)

Allahu i Madhëruar ka thënë për shfryrjen e Xhehenemit: **"Kur t'i shohë (Xhehennemi) ata (mosbesimtarët) nga një vend i largët, do dëgjojnë prej tij shfryrje dhe fërshëllima"**. (El-Furkan: 12)

Allahu i Madhëruar ka treguar për tymin, flakën dhe shkëndijat e tij e ka thënë: **"Të majtët. Eh ç'janë të majtët. Ata janë në nxehtësi dhe ujë të nxehtë. Në hije prej tymi. As të freskët e as të nderuar"**. (El-Uakiah: 41-44) Ajeti ka treguar ato gjëra me anë të të cilave freskohet njeriu në dynja prej të nxehtit e ato janë uji, ajri dhe hija. Ajri i Xhehennemit është era shumë e nxehtë, uji i tij është uji që ka arritur kulmin e nxehtësisë. Dhe hija e tij është prej shtëllungave të tymit. Allahu na ruajt prej këtyre me mirësinë dhe bujarinë e Tij!

Allahu i Madhëruar na ka treguar për zinxhirët dhe për prangat që vendosen në duar, qafë dhe në këmbë në Xhehennem ku thotë: "**Ne kemi përgatitur për mosbesimtarët zinxhirë, pranga dhe zjarr**". (El-Insan 4)

Gjithashtu ka thënë: "**Ne i kemi vendosur prangat në qafat e atyre që kanë mohuar**". (Sebe' 33) Gjithashtu ka thënë: "**Ne kemi (për ta) pranga dhe Xhehim (zjarr). Kemi ushqim që të gjec në fyt dhe ndëshkim të dhembshëm**". (El-Muzzemmil: 12-13)

Këtu kemi tre lloj ndëshkimi: **I pari** është dënimi i prangave që vendosen në qafë. **I dyti**: prangat që vendosen në duar dhe këmbë dhe i treti: zinxhirët.

Allahu i Madhëruar ka thënë : "**Më pas në një zinxhir (të gjatë) prej shtatëdhjetë parakrahësh futini**". I hyn zinxhiri nga prapanica dhe i del nga koka siç futen pulat në hell për t`u pjekur.

Allahu i Madhëruar ka treguar për gurët e Xhehennemit e ka thënë: "**O ju që keni besuar! Ruani veten dhe familjet tuaja nga Zjarri, lënda djegëse e të cilit janë njerëzit dhe gurët**". [Et-Tahrim: 6)

Gjithashtu ka thënë: "**Ruajuni prej Zjarrit, lëndë djegëse e të cilit janë njerëzit dhe gurët**". (El Bekareh 24) Dijetarët e tefsirit kanë rënë në kontradiktë se kush janë këta gurë. Disa prej tyre si Rabi Ibn Enesi janë të mendimit se ato janë gurët e statujave të cilat u adhuruan veç Allahut siç ka thënë Allahu i Madhëruar: "**Ju dhe ata që adhuronin veç Allahut do të jeni gurë të Xhehenemit. Në të do hyni**". (El-Enbija: 98)

Ndërsa shumica e dijetarëve të tefsirit janë të mendimit se këto gurë janë gurë squfuri prej të cilave ndizet zjarri. Thuhet se në të ka pesë lloje dënimi të cilat nuk ndodhen tek llojet e tjera të gurëve. Ndizen shpejt, kanë erë të keqe, nxjerrin shumë tym, ngjiten pas trupit të njeriut dhe çlirojnë shumë nxehtësi kur nxehen. Allahu na ruajt prej tyre!

Treguam pak më sipër për ushqimin dhe pijen e banorëve të Zjarrit. Allahu i Madhëruar na ka treguar se pija e tyre është katër lloje:

a) **El-Hamim** që është uji i nxehtë që djeg dhe pjek fytyrat e tyre dhe u këput zorrët e tyre copa-copa.

b) **El-Gas-sak** i cili është ujë i ftohtë që ka arritur kulmin e ftohtësisë.

c) **Qelbi** (i banorëve të Xhehenemit).

d) **Uji** që është si vaj i djegur, i zi, i trashë dhe me erë të ndyrë.

Shumë prej selefëve kur e kujtonin ushqimin e banorëve të Zjarrit dhe pijen e tyre, u largojë oreksi për të ngrënë bukë aq sa e linin atë. Imam Ahmedi thoshtë: “Frika prej Zjarrit më ka ndaluar që të ha dhe të pi aq sa nuk kam oreks”.

**"Ata kanë prej Xhehenemi shtrojë dhe sipër tyre mbulesë".** (El-A'raf: 41)

Profeti (sal-lAllahu alejhi ue sel-lem) ka treguar për madhësinë e trupave të banorëve të Zjarrit dhe për shëmtinë e pamjeve të tyre. Transmeton Buhariu nga Ebu Hurejre (radiAllahu anhu) se Profeti (sal-lAllahu alejhi ue sel-lem) ka thënë: **"Ndërmjet dy supeve të mosbesimtarit është largësia tri ditë për atë që ecën shpejt me kafshë"**.

Gjithashtu transmeton Muslimi nga Ebu Hurejre se Profeti (sal-lAllahu alejhi ue sel-lem) ka thënë: **"Dhëmballa e mosbesimtarit është si mali i Uhudit ndërsa trashësia e lëkurës së tij është tri ditë"**.

Allahu i Madhëruar ka thënë : **"Fytyrat e tyre i përpin Zjarri e ata bëhen (kalihune) të shëmtuar"**. (El-Mu'minin: 104) Dijetarët e tefsirit kanë thënë: “ (Kalihune) d.m.th. që buzët e tyre të sipërme e të poshtme u tkurren nga Zjarri dhe u shfaqen dhëmbët”.

Një prej ndëshkimeve që kanë banorët e Zjarrit është se ata tërhiqen zvarrë për fytyrat e tyre. "Atë ditë kur të tërhiqen zvarrë për fytyrat e tyre (e t`u thuhet) shijojeni fillimin e Sakarrit". (El-Kamer 48)

Disa banorë të Zjarrit ndëshkohen duke u ngjitur sipër e duke u hedhur nga lartë.

Ai që vret veten e tij është në Zjarr. Në hadithin që e transmetojnë Buhariu dhe Muslimi nga Ebu Hurejre, transmetohet se Profeti (sal-lAllahu alejhi ue sel-lem) ka thënë: **"Kush e vret veten me një hekur ai e mban atë hekur në dorën e tij dhe e ngul atë në barkun e tij në zjarrin e Xhehenemit në përjetësi. Kush e vret veten me helm, helmin do ta ketë në dorën e tij dhe e pi atë në zjarrin e Xhehenemit në përjetësi. Kush hidhet nga një mal dhe vret veten ai hidhet në zjarrin e Xhehenemit (nga lart poshtë) I përjetshëm"**.

Disa banorë të Zjarrit vijnë vërdallë në zjarr dhe tërheqin zorrët e tyre siç është treguar në hadithin e saktë të Usameh Ibn Zejdit.

Disa banorë të Zjarrit hidhen në një vend të ngushtë në të cilin njeriu nuk ka mundësi të lëvizë. Allahu i Madhëruar ka thënë: **"E kur të hidhen atje në një vend të ngushtë të prangosur do luten për vetët e tyre për shkatërrim"**. (El-Furkan: 13)

Ndëshkimi i mosbesimtarëve në Zjarr nuk shuhet, nuk ndërpritet dhe as nuk lehtësohet. Përkundrazi ai është i vazhdueshëm përgjithmonë. Allahu i Madhëruar ka thënë: **"Kriminelët do jenë të përjetshëm në Xhehenem. Nuk u lehtësohet dhe ata janë pa shpresë në të"**. (Ez-Zuhruf: 74-75)

**"Ata që kanë mohuar kanë zjarr Xhehenemi. Nuk u jepet fund që të vdesin dhe as nuk u lehtësohet ndëshkimi i tij"**. (El-Fatir: 36)

Ndëshkimi më i madh që kanë banorët e Zjarrit është që ata nuk e shohin Allahun dhe janë të larguar prej Tij. Ai është i zemëruar prej tyre. Allahu i Madhëruar ka thënë: **"Por jo, ata do jenë të penguar prej (shikimit të) Zotit të tyre"**. (El-Mutaffifin: 15)

Shiko se kush është dhurata që u jepet banorëve të Zjarrit kur hyjnë në të. Allahu na ruajt prej tij! Allahu i Madhëruar ka thënë: **"Më pas ju o të humbur e përgënjeshtues do të hani prej pemës Zekcum. Keni për t'i mbushur me të barqet. Mbi të keni për të pirë ujë të përvëlur. Keni për ta pirë atë si devetë e etura (shumë). Ky është nuzuli i tyre ditën e Llogarisë"**. (El-Uakiah: 51-56) Nuzul është ushqimi që përgatitet për mikun e porsaardhur.



Këto ajete tregojnë se banorëve të Zjarrit do t'u jepet për mikpritje prej pemës Zekcum dhe ujit të përvëluar kur të hyjnë në të, të etur. Allahu i Madhëruar ka thënë: "**Ne do t'i çojmë kriminelët në Xhehenem të etur**" (Merjem: 86)

Allahu na ka treguar të qarët e banorëve të Zjarrit, rënkimet e tyre, klithmat e tyre dhe lutjet e tyre të cilave nuk u përgjigjet kush. Allahu i Madhëruar ka thënë: "**Ata që u shkatërruan janë në Zjarr. Në të ata klithin dhe rënkojnë**". (Hud: 106)

Banorët e Zjarrit kërkojnë të dalin prej atje por nuk gjejnë përgjigje. Allahu i Madhëruar ka thënë: "**Ata thanë: Ne na mundi e keqja jonë e ishim njerëz të humbur. Zoti ynë na nxirr prej këtu e nëse ne kthehemi përsëri (tek punët e këqija) ne vërtetë jemi mizorë. U tha Rrini të poshtëruar në të dhe mos flisni**". (El-Mu'minun: 106-108) Gjithashtu Allahu i Madhëruar ka thënë: "**Ata thërrasin: O Malik, le të na vdesë ne Zoti yt. U thotë: Ju do qëndroni këtu**". (Ez-Zuhruf: 77)

Banorët e Zjarrit vazhdojnë të kenë shpresë se do shpëtojnë prej këtij dënimi deri sa të theret vdekja. Atëherë kur të theret e humbin shpresën dhe shtohet shumë pendimi i tyre dhe mërzia e tyre.

Buhariu dhe Muslimi kanë transmetuar nga Ebu Seid el-Hudriu (radiAllahu anhu) se Profeti (sal-lAllahu alejhi ue sel-lem) ka thënë : **"Do sillet vdekja ditën e gjykimit si dele me ngjyrë të bardhë e të zezë, vendoset ndërmjet Xhennetit edhe Xhehennemit e më pas jepet urdhër që të theret e thuhet: "O banorët e Xhennetit, keni përjetësi e s'keni vdekje. O Banorët e Zjarrit, keni përjetësi e s'keni vdekje".** Më pas Profeti (sal-lAllahu alejhi ue sel-lem) recitoi fjalën e Allahut të Madhëruar: **"Paralajmëroji ata për ditën e pendimit kur të vendoset çështja ndërsa ata janë të hutuar (tani) e nuk besojnë".** (Merjem: 39) Në një transmetim të Buhariut dhe Muslimit thuhet: **"E banorëve të Xhennetit u shtohet më shumë gëzimi ndërsa banorëve të Zjarrit u shtohet më shumë hidhërimi".**

Ardhja e Xhehennemit ditën e Gjykimit. Atë ditë Xhehenemi do nxjerrë një prej qafave të tij dhe do flasë. Allahu na ruajt prej tij!

Allahu i Madhëruar ka thënë: **"Atë ditë do të sillet Xhehennemi. Atë ditë do të kujtohet njeriu por si mund të përkujtohet atë ditë (kur nuk bën dobi përkujtimi)".** (El-Fexhr: 23)

Nga Ibn Mes'udi transmetohet se Profeti (sal-lAllahu alejhi ue sel-lem) ka thënë: "**Do sillet Xhehenemi ditën e Gjykimit. Ai ka shtatëdhjetë mijë frerë. Çdo fre e tërheqin shtatëdhjetë mijë melaike**". (Transmeton Muslimi)

Ndërsa Ahmedi transmeton nga Ebu Hurejre se Profeti (sal-lAllahu alejhi ue sel-lem) ka thënë: "**Do nxjerrë Xhehennemi një prej qafave të tij ditën e Gjykimit e do thotë: Mua më janë lënë në dorë tri veta: 1. Çdo person që mban veten të madh para njerëzve dhe është inatçi (kundrejt të vërtetës). 2. Çdo person që i lutet dikujt tjetër veç Allahut. 3. Çdo pikturues**". (Transmetojnë Ahmedi dhe Tirmidhiu)

Tregimi i hyrjes në Zjarr. Allahu na shpëtoftë prej tij me mëshirën e Tij sepse Ai është më i Mëshirshmi! Allahu i Madhëruar ka thënë: "**Çdonjëri prej jush ka për të hyrë në të. Kjo gjë për Zotin tënd ishte caktim i prerë. Më pas do shpëtojmë ata që ishin të devotshëm dhe do t'i lemë mizorët në të të gjunjëzuar**". (Merjem: 71-72)

Sahabët (dhe dijetarët) kanë disa mendime në kuptimin e fjalës "ka për të hyrë në të". Disa prej tyre thanë: Kjo hyrje është kalimi mbi urën e Siratit. Ky mendim është treguar nga Ibn Mes'udi, Xhabiri, el-Hasen el-Basri, Katade,

Abdurrahman Ibn Zejd Ibn Eslem, el-Kelbi e të tjerë. Ndërsa një grup tjetër kanë thënë që hyrja që tregohet në këtë ajet është hyrje e vërtetë. Ky mendim është mendim i njohur nga Ibn Abbasi. Transmetohet prej tij se ka thënë: Për besimtarin do jetë paqe dhe i ftohtë ndërsa për qafirat dhe mushrikët do jetë vend qëndrim. Mendimi i parë është më i saktë.

Kalimi i njerëzve mbi Urën e Siratit do jetë në bazë të punëve të tyre kush më shpejtë e kush më ngadalë. Kështu që hyrja e qafirrit është hyrje e vërtetë në Xhehennem ndërsa hyrja e besimtarit është kalimi mbi urën e Siratit.

Kur të qëndrojnë robi para Zotit të tij, Zjarrin do ta ketë përpara. Profeti (sal-lAllahu alejhi ue sel-lem) ka treguar se kur njeriu të dalë para Zotit të tij për të dhënë llogari do ta ketë Zjarrin përpara fytyrës së tij. E ka treguar se sadakaja e ruan njeriun nga Zjarri.

Transmetojnë Buhariu dhe Muslimi nga Adij Ibn Hatim se Profeti (sal-lAllahu alejhi ue sel-lem) ka thënë : **"Çdonjërit prej jush do t'i flasë Zoti i tij pa pasur ndërmjetës. Atëherë do shohë nga e djathta e tij e nuk sheh vetëm se punën e tij. Do shohë nga e majta e tij e nuk sheh vetëm se punët e tij. Do shohë përpara e nuk sheh**

**vetëm se Zjarrin para fytyrës. Prandaj ruajuni prej Zjarrit goftë edhe me një gjysmë kokërr hurme".** Në një transmetim të Buhariut thotë: **"E kush nuk gjen, atëherë të flasë fjalë të mira".**

Në hadithin e Abdurrahman Ibn Semuras tregohet se Profeti (sal-lAllahu alejhi ue sel-lem) ka thënë: **"Kam parë një person prej umetit tim që vendos duart para vetes që të ruajë fytyrën e tij prej nxehtësisë së Zjarrit dhe shkëndijave të tij. Ndërkohë i vjen sadakaja dhe i bën strehë mbi kokën e tij".** (Transmetojnë Ebu Musa el-Medini dhe Taberaniu) Shejhul Islam Ibn Tejmije e vlerësonte shumë këtë hadith dhe tregonte shumë fakte që e mbështesin saktësinë e tij.

Gjendja e njësuesve në Zjarr dhe dalja e tyre prej tij me mëshirën e më të Mëshirshmit dhe me ndërmjetësimin e ndërmjetësuesve. Është transmetuar në disa hadithe se njësuesit kalojnë mbi Urën e Siratit e shpëton kush shpëton e bie kush bie në Zjarr. E kur të hyjnë banorët e Xhennetit në Xhennet, shohin që u mungojnë vëllezërit e tyre njësues, të cilët kanë hyrë në Zjarr. Atëherë i luten Allahut të Madhëruar që t'i nxjerrë ata prej atje.

Banorët e vërtetë e të përhershëm të Zjarrit janë mosbesimtarët dhe mushrikët (idhujtarët). Ata janë të përjetshëm në të. Allahu i Madhëruar ka thënë: **"Është përgatitur për mosbesimtarët"**. (El-Bekare: 24)

Në hadithin e Buhariut dhe Muslimit tregohet se Allahu urdhëron Ademin të nxjerrë grupin e Zjarrit nga çdo një mijë veta nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë. Kjo gjë iu duk shumë e rëndë shokëve të Profetit (sal-l Allahu alejhi ue sel-lem) atëherë Profeti (sal-lAllahu alejhi ue sel-lem) tha: **"Prej je'xhuxh ma'xhuxhëve nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë, e prej jush një"**.

Është treguar në disa hadithe se shumica e bijve të Ademit janë prej banorëve të Zjarrit dhe se ata që kanë ndjekur Profetët janë pak në krahasim me të tjerët. E të tjerët janë të gjithë në Zjarr duke përjashtuar vetëm ata të cilëve nuk u ka mbërritur davja (thirrja) islame. Është treguar në disa hadithe që ky umet do ndahet në shtatëdhjetë e tre grupe. Të gjitha janë në Zjarr e vetëm një do shpëtojë. Ky grup është ai që ndjek rrugën e Profetit (sal-lAllahu alejhi ue sel-lem) dhe sahabeve të cilët kanë qënë të kapur pas Kur'anit dhe Sunnetit të Profetit (sal-lAllahu alejhi ue sel-lem) e ky është grupi i shpëtuar. Lus Allahun të na bëjë prej tyre!

Kur'ani tregon se shumica e njerëzve do jenë në Zjarr e këta janë ata të cilët do ndjekin shejtanin. Ndërsa prej njësuësve shumica e atyre që do hyjnë në Zjarr janë gra. Siç është treguar në hadithin që e transmetojnë Buhariu dhe Muslimi në hytben e Eklipsit, ku Profeti (sal-lAllahu alejhi ue sel-lem) ka thënë: "**Pashë Zjarrin e vura re që shumica e banorëve të tij ishin gra**". (Mutefekun alejhi)

Disa prej cilësive të banorëve të Zjarrit janë ato që i ka treguar Allahu në ajetet që vijojnë: "**Kush ishte shkaku që ju shkuat në Sakarr. Thanë: Ne nuk faleshim. Nuk ushqenim të varfrit. Futeshim tek e kota me ata që futeshin. Përgënjeshtrojmë Ditën e Llogarisë derisa na erdhi e sigurta** (vdekja)". (El-Muddeththir: 42-47)

Kështu që disa prej shkaqeve të cilat i çuan ata në Zjarr ishin se ata nuk faleshin, nuk jepnin zekatin, zhyteshin tek e kota dhe përgënjeshtrojmë Ditën e Gjykimit deri sa u erdhi vdekja në këtë gjendje. Allahu na ruajt!

Në hadithin e Buhariut dhe Muslimit tregohet se Profeti (sal-lAllahu alejhi ue sel-lem) ka thënë: "**A t`ju tregoj kush janë banorët e Zjarrit? Çdo njeri i ashpër (i vrazhdë në të kotën), koprrac dhe mendjemadh**".

Mendjemadhësinë e ka përshkruar Profeti (sal-l Allahu alejhi ue sel-lem) duke thënë: "**Mendjemadhësia është refuzimi i të vërtetës dhe nënvleftësimi i njerëzve**".

Gjithashtu Allahu ka thënë në Kur'an: "**A nuk ka vend në Xhehennem për mendjemëdhenjtë**". (Ez-Zumer: 60) Duket qartë nga hadithet se shëndeti i mirë trupor, pasuria, luksi dhe rendja pas kënaqësive të kësaj jete dhe mendjemadhësia janë prej cilësive të banorëve të Zjarrit.

Në librin e saktë të Muslimit tregohet se banorët e Zjarrit janë pesë:

a) I dobëti që nuk ka fuqi, as vendosmëri dhe as lakmi për të bërë mirë.

b) Tradhtari që nuk e fsheh lakminë e vet qoftë edhe në gjërat e vogla. Këtu hyn pakësimi i peshores. Tradhtia në porositë që të janë besuar prej njerëzve për t'i ruajtur. Këtu hyn edhe ai që tradhton Allahun dhe të Dërguarin e Tij (sal-lAllahu alejhi ue sel-lem) duke kryer gjynahe fshehurazi dhe duke u shfaqur para njerëzve sikur largohet prej tyre.

c) Mashtruesi që zakoni i tij është mashtrimi i njerëzve mëngjes e mbrëmje. Mashtrimi është cilësi e munafikëve. Mashtrimi d.m.th.: shfaqja e të mirës dhe



fshehja e të keqes. E me këtë mënyrë përpiqet ky njeri të marrë pasurinë e njerëzve dhe të përfitojë prej tyre. Profeti (sal-lAllahu alejhi ue sel-lem) ka thënë : "Kush na mashtron, nuk është prej nesh".

d) Koprracia dhe gënjeshtria. Të dyja këto e kanë burimin nga lakmia që ka njeriu për të marrë atë që nuk i takon.

e) Ai që është i paedukatë, i cili flet fjalë të ndyra. Në hadithin e Buhariut dhe Muslimit nga Aishja (radiAllahu anha) transmetohet se Profeti (sal-lAllahu alejhi ue sel-lem) ka thënë: "Njeriu më i keq tek Allahu Ditën e Gjykimit është ai person të cilit i largohen njerëzit ngaqë është i ndyrë (imoral në vepra e fjalë)". Tirmidhiu e transmeton hadithin me tekstin që vijon: "Njeriu më i urryer tek Allahu është imorali që ka gojë të pistë (flet fjalë të ndyra)".

Të parët që hyjnë në Xhehennem prej atyre që janë njësuës:

Transmeton Imam Ahmedi nga Ebu Hurejre (radiAllahu anhu) se Profeti sal-lAllahu alejhi ue sel-lem) ka thënë: *"M`u paraqitën tre personat e parë që do hyjnë në Xhennet dhe tre personat e parë që do hyjnë në Zjarr. Ata tre të*

*parët që do hyjnë në Xhennet janë: Dëshmori, skllavi të cilin nuk e preokupon skllavëria e tij nga bindja ndaj Allahut dhe i varfri i ruajtur (që nuk e shtrin dorën) dhe ka familje të madhe. Ndërsa tre të parët që do hyjnë në Zjarr janë: Princi që i shtyp njerëzit, pasaniku që nuk e jep hakun e Allahut në pasurinë e tij dhe i varfri mendjemadh".* (E transmeton Tirmidhiu këtë hadith dhe e ka cilësuar si të saktë) Cilësitë e këtyre janë padrejtësia, koprracia dhe mendjemadhësia.

Transmeton Muslimi nga Ebu Hurejre (radiAllahu anhu) në një hadith të gjatë ku ndër të tjera ka përmendur: luftëtarin, lexuesin e Kur'anit dhe atë që jep sadaka, të cilët i kryejnë këto vepra për t'u dukur para njerëzve. Më pas ka thënë: *"Këta janë tre të parët me të cilët ndizet zjarri"*. Sikurse është treguar në disa hadithe të tjera se kënduesit e Kur'anit të cilit janë njerëz të prishur hyjnë në Zjarr para mushrikëve (idhujtarëve).

Ibn Rexheb në librin e tij ka thënë: "Disa hadithe të cilat tregojnë se Xhehennemi nxjerr një nga qafat e tij Ditën e Gjykimit dhe flet dhe rrëmben ndërmjet njerëzve mushrikët, mendjemëdhenjtë dhe ata që pikturojnë. Në një transmetim tregohet se ai që vret një njeri pa të drejtë hyn në Xhehennem pesëqind vjet para të tjerëve. Është transmetuar nga Ibn Abbasi (radiAllahu anhu) dhe nga selefë të tjerë se kjo do të ndodhë para se të hapen librat dhe

të vendosen peshoret. Është treguar në një hadith nga Profeti (sal-lAllahu alejhi ue sel-lem) se kjo do të ndodhë para se të fillojë llogaria për njerëzit. Allahu e di më mire”.

### **Punët e banorëve të Xhennetit dhe punët e banorëve të Zjarrit.**

Është pyetur shejhu-l-islam Ibn Tejmije (Allahu e mëshiroftë): Cilat janë punët e banorëve të Xhennetit dhe cilat janë punët e banorëve të Xhehennemit ?

Përgjigje: Falënderimi i takon Allahut, Zotit të botëve. Punët e banorëve të Xhennetit janë: Besimi dhe devotshmëria. Ndërsa punët e banorëve të Zjarrit janë kufri, fisku (dalja nga kufijtë që ka vendosur Allahu) dhe gjynahet (në përgjithësi).

Punët e banorëve të Xhennetit janë: Besimi në Allahun, Melaiket, librat e Tij, Profetët e Tij, Ditën e Fundit dhe Besimi në Kaderin e mirë e të keq. Dëshmia e shehadetit me të dyja pjesët e saj. Dëshmia se askush nuk meriton të adhurohet veç Allahut dhe Muhamedi është i Dërguari i Allahut, kryerja e namazit, dhënia e zekatit, agjërimi i Ramazanit dhe Haxhi. Prej këtyre punëve janë: Ta adhurosh Allahun sikur ti e sheh Atë, e nëse ti nuk e sheh Atë, Ai të sheh ty. Prej punëve të banorëve të Xhennetit janë:

Fjalët e vërteta, ruajtja e amanetit, mbajtja e besës, mirësjellja me prindërit, lidhja farefisnore, bamirësia ndaj komshiut, jetimit, të varfrit, skllavit madje edhe kafshëve. Prej punëve të tyre gjithashtu është sinqeriteti, mbështetja tek Allahu, dashuria për Allahun dhe të Dërguarin e Tij (sal-lAllahu alejhi ue sel-lem), frika nga Allahu, shpresa tek mëshira e Tij, kthimi tek Ai, durimi për hir të Tij në atë që të cakton Ai dhe falënderimi ndaj mirësive të Tij. Prej punëve të tyre gjithashtu është leximi i Kur'anit, përmendja e Allahut, lutja e Allahut dhe kërkimi prej Tij. Prej punëve të tyre gjithashtu është edhe urdhërimi për të mira dhe ndalimi nga të këqijat, lufta në rrugën e Allahut kundër mosbesimtarëve dhe hipokritëve. Gjithashtu prej punëve të tyre është të afroresh me atë që të është larguar, t'i japësh atij që nuk të jep dhe të falësh atë që të bëri padrejtësi sepse Allahu e ka përgatitur Xhennetin për të devotshmit: **"Të cilët shpenzojnë në mirësi dhe vështirësi, të cilët e fshehin zemërimin e tyre dhe i falin njerëzit. Allahu i do bamirësit"**. (Ali Imran: 134) Prej punëve të banorëve të Xhennetit gjithashtu është edhe drejtësia në të gjitha çështjet e me të gjithë njerëzit, qofshin edhe me mosbesimtarët etj.

Kurse punët e banorëve të Xhehennemit janë: Shirku (idhujtaria), përgënjeshtimi i Profetëve, mohimi, hasedi (xhelozia), gënjeshtria, tradhtia, padrejtësia, imoraliteti, mashtrimi, këputja e lidhjeve farefisnore, lënia e luftës në rrugën e Allahut nga frika, koprracia, kontrasti ndërmjet anës së brendshme dhe anës së jashtme, humbja e shpresës nga mëshira e Allahut, siguria prej ndëshkimit të Allahut, trembja në fatkeqësi, mburrja në mirësi, lënia e detyrave që ka vendosur Allahu, shkelja e kufijve të Allahut dhe e shenjtërive që ka vendosur Ai, frika prej krijesave e jo prej Krijuesit, shpresa tek krijesat e jo tek Krijuesi, mbështetja tek krijesat e jo tek Krijuesi, punët që bëhen me syfaqësi, kundërshtimi i Kur'anit dhe Sunetit, bindja ndaj krijesave në atë që zemërohet Allahu, fanatizmi tek e kota, tallja me ajetet e Allahut, mohimi i të vërtetës, fshehja e asaj që duhet shfaqur qoftë ajo dije apo dëshmi. Prej punëve të banorëve të Zjarrit është magjia, sjellja e keqe me prindërit, vrasja e atij që e ka ndaluar Allahu ta vrasësh, ngrënia e pasurisë së jetimit, ngrënia e kamatës, mbathja nga fusha e betejës, akuza e grave besimtare të ndershme për imoralitet.

Sqarimi në formë të detajuar i çdonjërës prej këtyre është e pa mundur por punët e banorëve të Xhennetit hyjnë të gjitha tek bindja ndaj urdhrave të Allahut dhe të Dërguarit të Tij (sal-l Allahu alejhi ue sel-lem). Kurse punët e banorëve të Xhehenemit hyjnë tek kundërshtimi i urdhrave të Allahut dhe të Dërguarit të Tij (sal-l Allahu alejhi ue sel-lem): **"Kush i bindet Allahut dhe të Dërguarit të Tij e fut (Allahu) në Xhennete poshtë të cilave rrjedhin lumenj, të përjetshëm në to. Kjo është fitorja madhështore. E kush e kundërshton Allahun dhe të Dërguarin e Tij dhe i shkel kufijtë e Allahut e fut (Allahu) në Zjarr të përjetshëm e për të ka dënim poshtërues".** (En-Nisa: 13-14) Allahu e di më mirë". (Mexhmu' el-Fetaua 10/422)



# Malli për Xhennetin

Përgatiti:  
Abdul Uahid el-Magribi





Falënderimi i takon Allahut që e bëri Xhennetin e Firdeusit për robërit e Tij shpërblim, i Cili ua lehtësoi punët e mira që të çojnë atje e ata nuk u preokupuan me gjë tjetër veç tyre, i Cili ua lehtësoi rrugën që të çon për atje e ata e ndoqën atë me nënshtrim. Falënderimi i takon Allahut, i Cili i përgëzoi besimtarët me atë që ua tregoi me anë të Profetit të Tij (sal-lAllahu alejhi ue sel-lem) ku thotë: “Në të gjenden ato që nuk i ka parë syri nuk i ka dëgjuar veshi dhe nuk i ka shkuar ndër mend njeriu”. Falënderimi i takon Allahut që ua plotësoi besimtarëve përgëzimin duke i bërë të përjetshëm në Xhennet, nuk kërkojnë të largohen prej tij. Falënderimi i takon Allahut, Krijuesit të qiejve dhe të tokës i cili i bëri melaiket të dërguar. Falënderimi i takon Allahut i Cili kënaqet prej robit të Tij me pak. Falënderimi i takon Allahut që ia fali atyre shumicën e gjynaheve, u dhuroi atyre mirësinë dhe ia bëri detyrë Vetes mëshirën. Dëshmoj se nuk ka të adhuruar tjetër veç Tij dëshminë e atij që është robi i Tij, djalë i robit dhe robëreshës së Tij, që ka nevojë për Të në çdo moment dhe nuk ka shpresë për të hyrë në Xhennetin e Tij e të shpëtojë nga dënimi i Tij vetëm se me faljen dhe mëshirën e Tij.

Dëshmoj se Muhamedi është rob dhe i Dërguar i Tij, është besniku i shpalljes dhe më i zgjedhuri ndër krijesat e Tij. Allahu e dërgoi mëshirë për mbarë botët, argument për njerëzimin dhe shembull për ata që duan të

ndjekin (të vërtetën). Zoti i Tij e dërgoi që të ftojë në besim, të thërrasë për në Xhennet dhe të lexojë librin e Allahut për ta kënaqur Atë, për të urdhëruar për të mira dhe për të ndaluar nga të këqijat. I Lartë është Ai që ia zgjeroi kraharorin, ia fshiu gjynahet, ia ngriti emrin lart dhe i poshtëroi ata që e kundërshtojnë.

Allahu nuk i ka krijuar krijesat kot, nuk i ka lënë ata pa frerë. Përkundrazi i ka krijuar për një amanet të madh i cili iu paraqit qiejve dhe tokës dhe e kundërshtuan mbajtjen e tij.

Allahu i Madhëruar thotë (kuptimi i ajetit): **"Ne ia paraqitëm amanetin qiejve, tokës dhe maleve por ato e kundërshtuan mbajtjen e tij dhe u frikësuan prej tij. Ndërsa njeriu e mbarti atë, ai është i padrejtë, injorant"**. (El-Ahzab: 72)

Ky amanet që të çohet në vend duhet patjetër që të dëgjojmë dhe të bindemi, duhet patjetër ta adhurojmë Allahun dhe të kënaqemi me atë që na ka dhënë.

Shkaku i krijimit tonë është të adhurojmë Allahun dhe të ruhem i nga dënimi Tij. Prandaj kush arrin devotshmërinë i mjafton Allahu. Ai e shpëton atë nga çdo e keqe dhe e bën vendbanimi e tij Xhennetin.

E çuditshme është se njerëzit sot e dinë këtë gjë e megjithëkëtë atë janë të shkujdesur, e shohin përfundimin e atyre që adhurojnë krijesat dhe megjithëkëtë janë të dehur nga dashuria e kotë. E çuditshme është se ata mbështeten tek mëshira e Allahut dhe falja e Tij dhe e harruan dënimin dhe zemërimin e Tij.

Ata që patën sukses prej Allahut, kur e morën vesh pse janë krijuar, ngritën kokat lart dhe kur ja, shohin shenjat e Xhennetit nga larg, shohin rrugën e tij të drejtë, shumë qartë dhe u përqendruan mbi të. Këta janë të përmalluar për Xhennetin. Ata panë me syrin e zemrës se humbja më e madhe është të shesësh atë që nuk e ka parë syri, nuk e ka dëgjuar veshi e askujt nuk i ka shkuar ndër mend, askujt në këtë dynja të ulët e cila është si ëndrrat e gjumit, (ta ndërrosh) me këtë dunja e cila nëse të bën të qeshësh pak të bën të qash shumë e nëse të gëzon një ditë të hidhëron me muaj.

Prandaj është çudi për atë që i jep përparësi pjesës së pa vlerë që do mbarojë së shpejti për të lënë shpërblimin e lartë. Çudi për atë që shet Xhennetin i cili është i gjerë sa qiejt e toka për të fituar një burg kaq të ngushtë ndërmjet njerëzve të sëmurë. Çudi për atë që shet shtëpitë e mira tek Xhennetet nën të cilat rrjedhin lumenj me kasollet e ngushta që fundi i tyre është shkatërrimi.

Është për të ardhur keq pasha Allahu, për atë që nuk dëshiron të kënaqet duke parë fytyrën e Allahut Mëshiruesit për t'u kënaqur në dynja me fytyrat e shëmtuara.

Është për të ardhur keq pasha Allahun, për atë që nuk dëshiron të dëgjojë thirrësin e Xhennetit i cili thotë: O banorë të Xhennetit, kënaquni se nuk keni për t'u sëmurë dhe jetoni se nuk keni për të vdekur, keni për të qëndruar e nuk keni për t'u larguar nga këtu dhe keni për të qenë përjetësisht të rinj e nuk keni për t'u plakur". Por kënaqet duke dëgjuar këngëtarët dhe duke qëndruar me njerëzit e prishur.

O vëllezër të dashur! Atë Ditë do shfaqen pendimet dhe rënkimet, atje do bëhet e qartë mendjehetësia e atyre që janë të shkujdesur. Atje do merret vesh kush ka fituar dhe kush ka humbur. Atje do bëhet e qartë fitorja, e çfarë fitoreje se!! Ajo është fitorja e kënaqësisë së përhershme pranë Mëshiruesit, Mëshirëplotit. Sikur të zbulohet gajbi (e fshehta) o vëlla, do shikojë një pamje që të lumturon, do i shikojë ata nëpër kopshtet e Xhennetit lëvizin, mbi kolltukët e tyre ulen, me hurijet kënaqen dhe lloj-lloj frutash shijojnë. Atyre u shërbejnë djelmosha të përjetshëm me gota dhe ibrikë me verë; nuk i dhemb koka prej saj dhe as nuk dehen.

Çudi o vëllezër të dashur për atë që e dëgjon këtë përshkrim si fle gjumë, si nuk e përgatit pajën ai që kërkon të martohet (me hurijet), si jeton i qetë ai që ka mall pa i përqafuar virgjëreshat e Xhennetit, e si duron besimtari pa arritur atje?

Në të ndodhet ajo që syri nuk e ka parë, veshi nuk e ka dëgjuar, as mendja s'ë ka përfytyruar dot një gjë të gjashme me të. I Lartë është Allahu, Sunduesi.

Ky është malli për tek ai vend, ky është malli për të arritur kënaqësinë e Allahut, malli për të arritur faljen e Tij, malli për të arritur kënaqësinë e përhershme në Xhennetet e pafundme ku ka lumenj, në vendqëndrimin e të vërtetës tek Allahu Sunduesi, i Plotfuqishmi. Ky është malli për tek Xhenneti ku ndodhen hurijet e bukura dhe të sjellshme të cilat s'i ka prekur më parë as njeri e as xhind. Ky është malli për të parë Sunduesin, të Diturin e çdo gjëje në karriget e larta. Ky është malli i cili i zgjoi nga gjumi i natës njerëzit e mirë, ata që ishin të frikësuar të cilët e adhuronin Allahun shumë. Ky është malli i cili i shtyu ata që të përveshin krahët e vendosmërisë për në Xhennet. Ky është malli, të cilin nuk e ka shoqëruar mendjemadhësia, pëlqimi i vetes dhe as syefaqsia. Ky është malli i cili i shtyu ata që të ishin të sinqertë në fjalët, veprat dhe në të gjitha gjendjet e tyre.

Ky është malli i cili i bëri ata të kënaqen duke qëndruar vetëm, për të përkujtuar Allahun në çdo kohë edhe para ardhjes së agimit. Ky është malli që i shtyu ata të largohen nga të gjitha gjynahet duke pasur frikë se mos i fusë Allahu në Zjarr.

O vëllezër e motra! Do flasim për Xhennetin dhe përshkrimin e kënaqësisë së tij, me të cilin qetësohen shpirtat dhe e ëndërrojnë mendjet. Kush prej nesh nuk e ëndërron Xhennetin, cilin prej nesh nuk e ka marrë malli për Xhennetin?!

Ah Xhenneti, e ku e dini ju ç'është Xhenneti?! Në të ka drita që vetëtijnë, ka lule të bukura, ka kështjella të mëdha, lumenj që rrjedhin, ka fruta të pjekura dhe gra të bukura. Ka rrobe të shumta, shoqëri të pafund dhe jetë të përhershme. Nuk ka dyshim o vëllezër, se Xhenneti është qëllimi dhe synimi ynë, atë duam dhe për të na merr malli. Sepse ai është një shpërblim shumë i madh të cilin Allahu e ka përgatit për miqt dhe ata që i binden Atij.

Profeti (sal-Allahun alejhi ue sel-lem) na e ka përshkruar Xhennetin aq sa mendja ngelet e shtangur. E ne edhe pse po e përshkruajmë atë nuk mund ta përfytyrojmë dot atë, sidomos kur ta krahasojmë me këtë jetë të pa vlerë.

Prandaj Profeti (sal-lAllahu alejhi ue sel-lem) ka thënë: "**Vendi ku vendos njeriu shkopin në Xhennet është më i mirë se gjithë dunjaja dhe çka brenda saj**".

Kjo është diçka e paktë në Xhennet, e megjithëkëtë është më e mirë se gjithë dynjaja dhe çka brenda saj. Po mirësitë e pafundme si duhet të jenë?!

O vëllezër, ne kemi nevojë gjithmonë ta kujtojmë Xhennetin, në ruku, sexhde e në të gjitha gjendjet. Që të përvishemi dhe të na marrë malli, për të arritur atje. Që të largohemi nga gjynahet. Kështu që kur ndokush prej nesh kërkon të bëjë ndonjë gjynah ose të lejë ndonjë detyrë të kujtojë Xhennetin dhe ç'ka në të. Kush dëshiron të bëjë imoralitet le të kujtojë hurijet. Kush dëshiron të pijë alkool të kujtojë verën e Xhennetit me të gjitha llojet e saj. E kush dëshiron të dëgjojë muzikë të kujtojë këndimin e hurijeve i cili është i pa shembullt. Vëlla i dashur, motër e nderuar! A e keni ëndërruar ndonjëherë Xhennetin? A i keni derdhur lotët nga malli për të? A i jeni lutur Allahut me zemër që të mos ua ndalojë mirësinë e Tij? Siç na ka treguar Allahu për ata që falen natën, ku thotë (kuptimi i ajetit): "**Ata largohen nga krevatet dhe i luten Zotit të tyre me frikë, me shpresë dhe japin prej asaj që i kemi furnizuar. Askush nuk e di se çfarë kënaqësish ka fshehur Allahu për ta, si shpërblim për atë që punuan**". (Es-Sexhde: 16-17)



Përfytyroje veten vëlla se ke hyrë në Xhennet in shallah, përfytyro kur të jesh në kështjellat e Xhennetit me hurijet. Cilat janë ndjenjat e tua dhe çfarë gëzimi do kesh?! Ke për t' u përgëzuar shumë e ke të drejtë të gëzohesh kur të jesh prej banorëve të Xhennetit. Allahu na bëftë të gjithëve prej banorëve të tij!

Prandaj ejani me mua të përshkruajmë Xhennetin me ajetet e Kuranit dhe hadithet e qarta. Nuk do kemi mundësi ta përshkruajmë të gjithë sot por do tregojmë mirësitë më të mëdha në të.

Para se të fillojmë përshkrimin, dëgjoje një histori që tregon mallin për Xhennetin që kishte një djalë. Ai është Harithe. Një djalë nga ensarët. Historia e tij është e çuditshme.

Profeti (sal-lAllahu alejhi ue sel-lem) i thirri njerëzit të dalin për të shkuar në Bedër. Kur e dëgjoji këtë Harithe Ibn Suraka, shkoi tek nëna e tij (radiAllahu anha), e cila ishte e vjetër në moshë dhe e donte djalin e saj shumë. Ia kishte frikën edhe nga flladi i erës. Kur erdhi tek ajo i tha: O nëna ime, Profeti (sal-lAllahu alejhi ue sel-lem) i ka thirrur njerëz për të dalë me të e unë do dal me të.

Ia ktheu: O djali im, është shumë i vështirë për mua largimi yt, prandaj rri këtu me mua dhe mos shko. Por ai iu lut shumë duke i puthur kokën duar dhe këmbët deri sa i dha leje. I tha: Shko o djali im, se pasha Allahun nuk ha e as nuk pi dot, deri sa të kthehesh. Më pas ia veshi rrobat me duart e saj, ia dha armët dhe e puthi në ballë . E djali u largua. Kur shkuan muslimanët në Bedër, qëndruan tek pusi i Bedrit deri sa kur u radhitën dy grupet për luftë, shkoi Harithe tek pusi për të pirë ujë. Kur një prej sahabeve po ruante pusin që të mos vinin mushrikët për të pirë. Kur e pa Harithen mendoi se ishte ndonjë prej mushrikëve, mori një shtizë dhe e lëshoi atë me forcë deri sa i ra në gjoks. Ra Harithe përtokë i përlyer me gjak. Kërkonte ndihmë por askush nuk i përgjigjej, duke menduar se është prej mushrikëve. Kur vdiq Harithe, erdhi sahabi që ruante ujin për të parë kush është, por ç`të shohë, qenka Harithe. Tha: La haule ue la kuete ila bilah, La haule ue la kuete ila bilah. Shkoi tek Profeti (sal-l Allahu alejhi ue sel-lem) dhe i tregoi për ç'ka ndodhi. E Profeti (sal-l Allahu alejhi ue sel-lem) ia fali.

Pasi mbaroi lufta, me fitoren e muslimanëve dhe u kthyen për në Medine, dolën fëmijët për të pritur baballarët e tyre, dolën gratë për të pritur burrat e tyre dhe dolën nënat për të pritur fëmijët e tyre. Kur ja, nëna e Harithes është në këmbë dhe po pret. Erdhi i pari, i dyti, i njëqindti, por Harithe nuk

po vjen. Ndërkohë që nëna e tij po pret djalin e saj që e donte aq shumë. E filloi të pyesë për të çdo person që kalonte. Ndaloj nëna e Harithes një prej sahabeve dhe i tha: A e njeh Harithe Ibn Surakan? I tha: Po. Çfarë e ke ti atë? Tha unë jam nëna e tij. I tha: Ti je nëna e Harithes?! Bëj durim dhe llogarit shpërblimin tek Allahu, se djali yt u vra. Kur e dëgjoji nëna fjalën "u vra", kujtoi Xhennetin dhe shpërblimin që ka përgatitur Allahu për dëshmorët dhe tha: Allahu Ekber. Djali im shehid, do më ndërmjetësojë për të hyrë në Xhennet. I tha: Nuk mendoj se është shehid. I tha: Pse, a nuk e vranë mosbesimtarët? Tha: Jo. Tha: A nuk u vra duke luftuar ndërmjet muslimanëve dhe mosbesimtarëve? I tha: Jo. Tha: A nuk u vra duke ngritur flamurin Islam? I tha: Jo. Tha : Si qenka vranë atëherë?! Ku është djali im Harithe? I tha: Nuk mendoj se është shehid, por të shpresojmë se Allahu mund ta fusë në Xhennet. Kur e dëgjoji këtë gjë nëna e Harithes tha: Ku është Profeti (sal-lAllahu alejhi ue sel-lem)? I tha: Ja ku është duke ardhur. Shkoi nëna dhe lotët i lagën faqet. Kur erdhi tek Profeti (sal-lAllahu alejhi ue sel-lem) i tha: O i Dërguari i Allahut, ti e di sa e dua unë Harithen dhe njerëzit e dinë këtë gjë. Mora vesh se Harithe u vra. O i Dërguari i Allahut, më trego ku është Harithe tani. Nëse është në Xhennet, do bëj durim dhe nëse është diku tjetër, do ta shikojë Allahu se çfarë do veproj, (d.m.th do vajtoj shumë). Profeti (sal-lAllahu alejhi ue sel-lem) e pa e i tha: E mjera ti, o nëna e Harithes, a u

çmende!! A një Xhennet i vetëm është?! Ato janë shumë dhe djali yt ka arritur Firdeusin e lartë. Kur e dëgjoji këtë gjë, iu tha loti, iu kthye logjika në vend dhe tha: Allahu Ekber. Pastaj u kthye në shtëpi, që të priste vdekjen, që të takohej me djalin e saj në Xhennet.

A e dëgjuat, a e dëgjuat mallin e djalit dhe nënës së tij për Xhennetin?

Ky është malli për Xhennetin. Pasha Allahun, për sa e sa besimtarë dhe besimtare të devotshëm e mori malli Xhennetin. Siç i kishte marrë edhe ata malli për Xhennetin. Këta sakrifikuan çdo gjë me vlerë për të arritur Xhennetin. Pasha Allahun, sa e sa njerëz i shtyu vendosmëria e tyre për të arritur Xhennetin. Shkuan rrugës për atje duke u nxitur nga malli për të, nuk u dëmtuan nga sprovat e dunjasë. Prandaj Allahu ua dha Xhennetin si shpërblim për durimin që bënë.

Po ne, a vepruam si ata nga malli për Xhennetin apo malli ynë për dunjanë, postet dhe pasurinë është më i madh se malli ynë për Xhennetin. Allahu na ruajt!

O vëllezër, pas kësaj historie ejani me mua për në Xhennet, ejani ta përshkruajmë atë. Ejani tek ajo mirësi e përjetshme e pafund. Ejani me zemrat tuaja. Përfytyroje o

o vëlla veten tënde në Xhe-net, po ha prej fryteve të tij dhe po përqafohet hurijtë e Xhennetit.

Atëherë dëgjoje përshkrimin dhe ec me vendosmëri për në Xhennet me punët e tua të mira, me sinqeritetin tënd. Ec me vendosmëri, me shpresë se do jesh prej banorëve të tij. E mos të preokupojë kjo jetë. Jeta e streseve dhe shqetësimeve. Ky është malli (i vërtetë). Vëlla, a ke rendur për t' u fejuar në Xhennet, duke bërë punë të mira. Nëse po, atëherë dëgjoje të përmalluarin, Ibnul Kajimin, kur e përshkruan atë duke thënë:

*O ti që kërkon të fejojesh me hurijet e bukura dhe kërkon të jesh me to në Xhen-netet e përhershme.*

*Sikur ta dije ti me kë dëshiron të fejojesh dhe kë po kërkon do jepje çdo gjë të shtrenjtë që ke.*

*Ose po ta dije se ku jeton ajo do ecje për tek ajo edhe me qepalla (nëse nuk do të mjaftonin këmbët).*

*Unë ta kam përshkruar rrugën për tek vendbanimi i saj, nëse dëshiron ta takosh mos ji I ngathët.*

*Shpejto dhe nxito sa të kesh fuqi sepse ecja jote një orë do jetë gjithsej.*

*Prandaj dashuro, foli vetes për takimin me të dhe jepet pajën deri sa të të jepet mundësia.*

*Agjëro para se ta takosh atë se dita e takimit me të është dita e çeljes dhe mbarimit të Ramazanit.*

*Le të jenë cilësitë e bukurisë së saj nxitës për ty, ec rrugës që do hasësh frikë se atje tek ajo je i sigurt.*

*Mos të të preokupojë vendi të cilin e kanë luajtur sprovat me duart e tyre.*

*Është larguar prej tij çdo gëzim dhe në vend të tij ka ardhur stresi dhe shqetësimi.*

*Ai është burg për besimtarët dhe Xhennet për mosbesimtarët.*

*Sikur dunjaja të vlente tek Allahu sa krahu i një mushkonje nuk do i jepte Allahu mosbesimtarëve të pinin (qoftë edhe një gotë ujë).*

*Por ajo është më e pa vlerë tek Ai se krahu i mushkonjës. Natyra e saj është e turbullt (nuk ka kënaqësi të kulluara), si mund ta arrijë atë të pastër njeriu, kjo është e pamundur.*

*O ti që je dashuruar pas dunjasë, përgatitu për atë që kanë marrë të dashuruarit gjatë kohërave.*

*A nuk i ke dëgjuar? Përkundrazi i ke parë vetë me sytë e tu të orarët nga dashuria e dunjasë, pleq e të rinj.*

Ky është malli për Xhennetin. O vëllezër, mirësitë e Xhennetit janë shumë larg nga përshkrimi ynë. Sepse përfytyrimi ynë është shumë i ngushtë. Mirësitë e tij nuk kanë shëmbëlltyrë nga gjërat që i njohin banorët e dunjasë. Sa do që të përparojnë njerëzit në dunja, ngelet ajo që arrijnë, diçka tepër e vogël në krahasim me mirësinë e Xhennetit.

Nga malli për Xhennetin e pyetën sahabet Profetin tonë (sal-lAllahu alejhi ue sel-lem) për banesat e tij. Profeti (sal-lAllahu alejhi ue sel-lem) u tregoi për banesat e Xhennetit gjëra të çuditshme i bëri ata që t'i marrë malli për të më shumë dhe të rendin me shpirtrat e tyre drejt tij, u tha: **"Një tullë është prej ari, një prej argjendi, Ilaçi ndërmjet tullave është parfum misku. Guralecët e tij janë prej gurëve të çmuar. Dheu i tij është prej Za'ferani. Kush hyn në të, vetëm mirësi do ketë dhe asnjë të keqe. Do jetë i përjetshëm. Nuk i vjetrohën rrobat dhe as nuk plaket"**.

Allahu i Madhëruar ka thënë (kuptimi i ajetit): **"Kur të shohësh atje ke për të parë mirësi dhe pronësi të mëdha. Kanë veshur rroba prej mëndafshi të hollë jeshil e të trashë. Në duart e tyre kanë byrzylykë prej argjendi dhe Zoti i tyre u dha pije të pastër (të këndshme për të pirë)".** (El-Insan: 20-21)

Mirësitë e tij që nuk i dimë janë më të mëdha, të cilat nuk i koncepton dot logjika jonë.

Prandaj dëgjoje përshkrimin e Xhennetit, që të të marrë malli për të. I përmalluari, Ibnul Kajimi thotë:

*Prandaj dëgjoje përshkrimin e tij dhe cilësitë e tij, se ai është vendi i hurijve të bukura.*

*Xhenneti është i mirë dhe kënaqësitë e tij janë të mira, të pashterueshme dhe nuk mbarojnë.*

*Vendbanimi i paqes quhet dhe Xhenneti Me'ua gjithashtu. Ai është vendi i ushtrisë së besimit dhe Kur'anit.*

*Kështu që vendbanimi është paqe, përshëndetja e tyre është paqe dhe Selam është emër i Allahut.*



A i dëgjove o vëlla, ai i dëgjove o motër. Atëherë dëgjoje Profetin (sal-lAllahu alejhi ue sel-lem) kur tregon gradat e Xhennetit, ku thotë: **"Në Xhen-net gjenden 100 grada i ka përgatitur Allahu për luftëtarët në rrugën e Tij. Largësia ndërmjet dy gradave është si largësia ndërmjet tokës dhe qiellit. Kur t`i luteni Allahut kërkojini që t`ju fusë në Firdeus se ai është Xhenneti më i lartë dhe është në mes të Xhenneteve, sipër tij është Arshi i Mëshiruesit dhe prej tij burojnë të gjithë lumenjtë e Xhennetit"**.

Më pas Profeti (sal-lAllahu alejhi ue sel-lem) na e shton më shumë mallin për Xhennetin duke i përshkruar gradat e Xhennetit, ku thotë: **"Banorët e Xhennetit i shohin banorët e dhomave siç shihni yllin që ndriçon larg në qiell. I thanë : O i Dërguari i Allahut, këto grada nuk i arrin kush tjetër veç profetëve .Tha : Po, pasha Atë në dorë të të Cilit është shpirti im, do t`i arrijnë njerëz që besuan Allahun dhe profetët"**.

O ju që u ka marrë malli për Xhennetin! Xhenneti është me grada njëra mbi tjetrën dhe banorët e tij janë në grada të ndryshme në bazë të besimit të tyre. Prandaj duhet ta besojmë atë që na e solli Profeti (sal-lAllahu alejhi ue sel-lem) që të jemi prej atyre banorëve.

Allahu i Madhëruar thotë (kuptimi i ajetit): **"Kush shkon tek Allahu besimtar dhe ka kryer punë të mira për të do jenë gradat e larta. Xhennetet e Adnit nën të cilat rrjedhin lumenj, janë të përjetshëm në të. Ky është shpërblimi i atij që e pastron veten e tij (nga të këqijat)".** (Taha: 75-76)

O vëllezër! Dijetarët kanë grada të veçanta për shkak të dijes së tyre, punëve të mira dhe ftesës në të mira.

Allahu i Madhëruar thotë (kuptimi i ajetit): "... **Allahu ngre lart ata që kanë besuar prej jush, ndërsa ata që kanë dije në grada shumë të larta. Allahu është i Mirënjohur për atë që punoni".** (El-Muxhadeleh: 11)

Ky është malli për këto grada të larta. Banorët e Xhennetit nuk janë të njëjtë në mirësitë dhe kënaqësitë e Xhennetit. Përkundrazi çdo gradë ka mirësitë dhe kënaqësitë e veta që ndryshojnë nga grada që është poshtë saj. Sa më e lartë të jetë grada aq më e madhë është mirësia dhe kënaqësia.

Allahu i Madhëruar thotë (kuptimi i ajetit): **"Njerëzit e mirë janë në mirësi mbi krevate, janë duke shikuar. E sheh në fytyrat e tyre shkëlqimin e mirësisë. U jepet për të pirë nektar i vulosur me misk. Për këtë le të**

**konkurojnë ata që duan të konkurojnë. I përzier me tesnim. Ai është burim në Xhennet prej të cilit ngopen duke pirë besimtarët e afërt tek Allahu". (E-Mutaffifin: 22-28).**

Për këtë nektar kanë thënë dijetarët që është lloji më i mirë i verës (në Xhennet). Ndërsa tesnimi është pija më e mirë në Xhennet. A po konkurojnë besimtarët për këtë sot?!

Një prej mirësive të gradave të larta është se dëshmori martohet me 72 hurije. Ndërsa ai që ka gradën më të ulët në Xhennet është ai që ka dy gra prej hurijve. I shkojnë hurijtë dhe i thonë: Falënderimi takon Allahut që na krijoi ne për ty dhe ty për ne. Thotë: Askujt nuk i është dhënë kjo që më është dhënë mua, askujt nuk i është dhënë kjo që më është dhënë mua. Gjithashtu banorët e Xhennetit ndryshojnë në bazë të gradave që kanë në shikimin e Allahut të Madhëruar.

Disa prej tyre e shohin çdo mëngjes dhe mbrëmje e disa e shohin çdo ditë xhumaje. Ky është malli për të arritur këto grada, malli për të qënë pranë Profetit tonë (sal-Allahu alejhi ue sel-lem) dhe pranë sahabeve të nderuar.

Dëgjoje ç'thotë i përmalluari, Ibnul Kajimi për dallimin që kanë gradat nga njëra-tjetra.

*Gradat e tij janë një qind dhe ndërmjet çdo dy gradave në bazë të llogarisë*

*Është një largësi si nga toka në qiell, kjo është fjala Profetit të vërtetë.*

*Por më i larti është Firdeusi sipër të cilit është Arshi i Krijuesit, Mëshiruesit.*

*Ai që ka gradat më të larta e shikon Zotin e tij dy herë në ditë.*

*Ndërsa ai që ka gradën më të ulët me gjithë se nuk ka të ulët në Xhennet,*

*Është ai që i ka pronat e tij dy mijë vjet largësi.*

*Ai e sheh atë që është në fund, siç sheh atë që ka pranë vetes.*

*A nuk e ke dëgjuar që të fundit person që hyn në Xhen-net i jep Allahu Falësi.*

*Dhjetëfishin e gjithë dunjasë, i lartë është Allahu Bamirësi i Madh.*

Ky është malli për Xhennetin vëllezër. Ndër të tjera ne do flasim edhe për portat e Xhennetit që të të shtohet malli për të hyrë nga ato porta.

Allahu i Madhëruar thotë (kuptimi i ajetit): "**Ato janë Xhennetet e Adnit portat e tyre janë të hapura**". (Sad: 50)

Gjithashtu thotë (kuptimi i ajetit): "**Melaiket u hyjnë atyre nga çdo portë: paqja qoftë mbi ju për durimin që bë të, sa përfundim i mirë është ky vendbanim**". (Er-Ra'd: 23-24)

Portat hapen kur arrijnë atje besimtarët të cilët i presin melaiket duke i përshëndetur me selamin e mirëseardhjes.

Allahu i Madhëruar thotë (kuptimi i ajetit): "**Derisa kur të vijnë do ju hapen atyre portat dhe do t'u thonë atyre melaiket e Xhennetit: selamun alejkum, jeni të mirë prandaj hyni në të në përjetësi**". (Ez-zumer: 73)

Po o banorët e Xhennetit, jeni të mirë sepse në dunja ishit të mirë me fjalët dhe veprat tuaja. Gjithashtu edhe në ahiret jeni të mirë me hyrjen në Xhennet. Sa shpërblim i mirë është shpërblimi atyre që punuan!

Portat e Xhenetit janë tetë. Profeti (sal-lAllahu alejhi ue sel-lem) thotë: *"Xhenneti ka tetë porta, ndër to është një portë që quhet Rajjan nuk hyn nga kjo portë askush veç agjëruesve. Kur të hyjnë mbyllet dhe askush nuk hyn më nga ajo portë"*.

Atje ka portë për namazin, portë për ata që japin sadaka, portë për ata që kanë luftuar në rrugë të Allahut. Siç na ka treguar Profeti (sal-lAllahu alejhi ue sel-lem). Ebu Bekri (radiAllahu anhu) nga malli që kishte për Xhennetin e pyeti Profetin (sal-lAllahu alejhi ue sel-lem): A do thirret nga të gjitha portat ndonjë njeri o i Dërguari i Allahut? I tha : Po dhe shpresoj që ti të jesh prej tyre.

Vëlla, e ti motër, nëse dëshironi t`ju hapen këto porta, jini të sinqertë në fjalë dhe vepra. Merr abdes siç duhet e ngrije shikimin lart dhe thuaj: **"Eshhedu en la ilahe ila Allah uahdehu la sherike lehu ue eshhedu ene Muhameden abduhu ue resuluhu, Allahume xh'alni minet-teuabine ue xh'alni minel mutetahirine"** që të të hapen të teta portat e të hysh nga cila portë të dëshirosh.

Largësia ndërmjet dy anëve të një porte është dyzet vjet. E do vijë një ditë që atje do ketë fluks të madh njerëzish. Siç ka thënë Profeti (sal-lAllahu alejhi ue sel-lem).

Atë ditë ndryshojnë gradat e besimtarëve nga njëri-tjetri kur të hyjnë nga ato porta. Çdo grup ka ngjyrë dhe bukuri që nuk e ka tjetri. Profeti (sal-lAllahu alejhi ue sel-le) ka thënë: "**Grupi i parë që hyn në Xhennet, fytyrat e tyre janë si hëna kur është e plotë. Ndërsa ata që vijnë pas tyre i kanë si ylli më ndriçues në qiell**". E më pas në Xhennet kanë gradat e tyre.

Ky është malli që i nxit ata. Kjo është puna e tyre me të cilën fituan dhe mbërritën tek portat e Xhennetit. Ky është besimi i tyre, devotshmëria e tyre dhe largimi nga imoraliteti dhe veprat e këqia.

Dëgjoje të përmalluarin, Ibnul Kajimin që thotë për portat e Xhennetit:

*Portat e tij me të vërtetë janë tetë siç janë transmetuar në hadith e ato janë për atë që ka arritur gradën e ihsanit.*

*Me e larta është porta e luftës ndërsa porta e agjërimit quhet Rrajjan.*

*Do thirren disa nga të gjitha portat nëse i kanë plotësuar degët e besimit.*

*Prej tyre është Ebu Bekri i cili është Sidik dhe është zëvendësi i atij që i zbriti Kur'ani.*

*Por hapja e portës nuk është e mundur pa çelës me dhëmbëza.*

*Çelësi është dëshmia e njësimimit dhe sinqeritetit. Kjo është dëshmia e besimit.*

*Ndërsa dhëmbëzat janë punët e mira për të cilat urdhëron Islami dhe çelësi duhet të jetë me dhëmbëza.*

**Ibnul Kajimi thotë në përshkrimin e grupit të parë që hyn në Xhennet :**

*Grupi i parë që hyn në Xhennet fytyrat e tyre jani si hëna e katërmbëdhjetë.*

*Këta janë të parët sepse edhe në dunja ishin të parët në punët e mira.*

*Ndërsa grupi tjetër si ylli më i ndritshëm që shikon syri yt në horizont.*

*Krehërat e tyre janë prej ari dhe djersa e tyre është misk i pastër, o i mjeri ai që e humbi këtë mirësi.*



Ky është malli o vëllezër për Xhennetin. O vëllezër të dashur! Banorët e Xhennetit kur të hyjnë nga ato porta do t'u ndryshojë ngjyra dhe pamja. Nuk do jenë siç kanë qenë në këtë dunja të ulët, tek e cila ka vetëm mangësi. Ndërsa banorët e Xhennetit kur hyjnë në Xhennet hyjnë në më të plotën dhe më të bukurën pamje. Ata do jenë në pamjen e babait të tyre, Ademit (aleji selam) dhe në gjatësinë e tij 60 parakrahë. Profeti (sal-lAllahu alejhi ue sel-lem): ka thënë **"Çdokush që hyn në Xhennet do jetë në pamjen e Ademit (aleji selam) me gjatësinë e tij 60 parakrahë"**.

Gjithashtu edhe shpirtrat e tyre do jenë të pastra nuk do kenë urrejte për njëri-tjetrin dhe as hased, siç ka thënë Profeti (sal-lAllahu alejhi ue sel-lem).

Ajo që ua shton më shumë bukurinë është se ata nuk do kenë qime në trup dhe as mjekra dhe do jenë në të njëjtën moshë, 33 vjeç . Mosha e rinisë dhe forcës.

Profeti (sal-lAllahu aleji ue sel-lem) thotë: **"Banorët e Xhennetit hyjnë në Xhennet pa qime, pa mjekra, sytë i kanë të lyera me kohl në një moshë të gjithë 33 vjeç"**.

Kjo është për sa i përket burrave. Ndërsa gruaja besimtare e devotshme e ruajtur dhe e kujdesshme është hurije nga hurijet më të bukura në Xhennet.

Vëlla i dashur, motër e nderuar! A nuk ju tronditi malli që të jeni prej tyre? Dëgjoje Ibnul Kajimin kur e përshkruan këtë gjë duke thënë :

*Mosha e tyre është 33 vjeç në të cilën është fuqia e rinisë.*

*Gjatësia e tyre është sa gjatësia e babait të tyre 60 parakrahë ndërsa gjerësia 7 parakrahë.*

*Ngjyra e tyre është e bardhë, nuk kanë mjekra, flokët do ti kenë me onde dhe sytë të lyera me kohl.*

*Kjo është bukuria më e plotë e lëkurës, flokëve dhe syve të tyre.*

Ky është malli për Xhennetin. O ti që je i përmalluar për Xhennetin, eja me mua që të njohësh si është ndërtuar Xhenneti, si janë guralecët e tij, toka e tij, uji i tij, dhomat e tij, çadrat e tij dhe mirësitë e përhershme që ndodhen në ato çadra.

Është transmetuar në librin e saktë të Buhariut dhe Muslimit se Profeti (sal-lAllahu alejhi ue sel-lem) ka thënë: **"U futa në Xhennet, kur ç`të shoh, gurët ishin perla dhe dheu ishte misk". Në një transmetim thuhet, "dheu ishte i bardhë si misk I pastër".**

Kur të vendosin banorët e Xhennetit këmbët mbi të, të gëzuar, të sigurt, ecin, kur shohin kështjellat dhe çadrat e tyre u shtohet më shumë malli për to.

Profeti (sal-lAllahu alejhi ue sel-lem) ka thënë: **"Besimtari do ketë në Xhennet një çadër prej margaritari 60 milje e lartë. Në të do ketë gratë e tij. Shkon tek to besimtari një nga një, nuk e shohin njëra-tjetrën nga gjerësia e vendit".** Allahu i ka përgatitur këto çadra për robërit e Tij të devotshëm.

**"Ata do kenë gradat më të larta të Xhennetit për durimin që kishin dhe do gjejnë në të përshëndetje dhe paqe".** (kuptimi i ajetit) (El-Furkan: 75)

Allahu i Madhëruar thotë (kuptimi i ajetit): **"...ndërsa ata që kanë qenë të devotshëm do të kenë dhoma njëra mbi tjetrën të ndërtuara, poshtë tyre rrjedhin lumenjtë. Ky është premtimi i Allahut. Allahu nuk e thyen premtimin".** (Ez-Zumer: 20)

O vëllezër! Profeti (sal-lAllahu alejhi ue sel-lem) thotë: "Në Xhennet ka dhoma të tejdukshme që shikohet jashtë ç`ka brenda dhe brenda ç`ka jashtë. Allahu i ka përgatitur për ata që ushqejnë të varfrit, që flasin butë, që agjërojnë vazhdimisht dhe ata që falen natën kur njerëzit flenë".

Prandaj, ejani o vëllezër dhe ju o motra të ushqejmë të varfrit, ejani të agjërojmë dhe të falemi natën që të jemi prej banorëve të këtyre dhomave.

Ky është malli për tek ato dhoma. E nëse je prej atyre që agjërojnë dhe falen (natën) dëgjoje çfarë thotë Ibnul Kajimi:

*Ndërtesat e Xhennetit janë prej tullave prej ari dhe argjendi, janë dy lloje të ndryshme.*

*Ndërsa kështjellat janë prej perlave dhe zeberxhedi (gur i çmuar ngjyrë jeshile), prej argjendi ose prej ari të kulluar.*

*Gjithashtu janë prej perlash (të mëdha) dhe rubini, kështu është përsosur ndërtimi (i tyre) në formën më të mirë.*

*Ndërsa balta është prej misku të kulluar ose za'ferani. Janë transmetuar dy hadithe të sakta për këtë.*

*Ndërsa guralecët e Xhennetit janë perla të përmasave të ndryshme dhe rubin të shpërndara siç mund të shpërndahen gurët e çmuar.*

*Dheu i Xhennetit është prej za'ferani ose prej miskut që është marrë prej drerëve.*

*Dhomat e Xhennetit janë në hapësirë, shikon nga brenda ç'ka përjashta dhe nga jashtë ç'ka brenda.*

*Banorët e tyre janë ata që falen natën, agjërojnë, flasin fjalë të mira dhe janë bamirës.*

*Robi do ketë në Xhennet një çadër prej perle e hapur nga brenda. Ky është krijimi i Mëshiruesit.*

*Ajo është 60 milje e lartë. Në çdo anë të saj gjenden gratë më të bukura.*

*Besimtari shkon tek të gjitha e ato nuk e shohin njëra-tjetrën ngaqë është vend shumë i madh.*

*Në të ka dhoma të veçanta dyert e tyre janë prej ari dhe margaritari të zbukurara me korale.*

*Këto çadra janë në koshpte buzë lumenjve që rrjedhin.*

*Në çadra ndodhen ato (huri) që po të dalin para diellit dhe hënës ke për të thënë që është bërë eklipsi I tyre.*

*Sa e sa plagë dhe mall ka në zemër për këto çadra.*

*Në to ka hurij që ulin shikimin, të mira në sjellje, të bukura, nuk ka si ato në bukuri.*

*Të mira në sjelljet e tyre, të bukura në fytyrat e tyre e kështu e mira dhe bukuria është përputhur (tek to).*

Ky është malli o vëllezër. Kur të vendosen banorët e Xhennetit në kështjellat dhe çadrat e tyre u jep Allahu rizikun tyre i cili u sjell atyre kënaqësi, fruta të shumëllojshme që të hanë prej tyre dhe u sjell lumenjtë që të pijnë prej tyre.

Allahu i madhëruar thotë (kuptimi i ajetit): **"Të djathtët. Çfarë janë të djathtët!! (Ata janë) në mes të sidrit që nuk ka gjemba, bananeve palë-palë, në hije të përhershme, kanë ujë të rrjedhshëm që nuk ndërpritet kurrë. Kanë fruta të shumta as nuk mbarojnë dhe as nuk ua ndalon (kush)".** (El-Uakia: 27-33)

D.m.th të shumta, të mira, të shumëllojshme e me gjithë këtë ato edhe prodhojnë gjithmonë. Hija e tyre është e

përhershme dhe janë afër (dorës). I marrin banorët e Xhennetit shumë lehtë.

Allahu i Madhëruar ka thënë (kuptimi i ajetit): **"Përshkrimi i Xhennetit që është përgatitur për të devotshmit (ndër të tjera është) se poshtë tij rrjedhin lumenjtë. Ushqimi dhe hijet e tij janë të përhershme. Ky është përfundimi i atyre që ishin të devotshëm ndërsa përfundimi i atyre që kanë mohuar është Zjarri".** (Er-Rad: 35)

Ndërkohë që banorët e Xhennetit janë duke u kënaqur me këto fruta kur shohin një pemë të madhe. Ecën kalorësi në hijen e saj njëqind vjet e nuk e kalon dot. Kjo është mirësi e banorëve të Xhennetit e përhershme. Pranda ec me seriozitet dhe vendosmëri o vëlla dhe ndizja mallin vetes tënde që të jesh prej banorëve të Xhennetit. Duke bërë sa më shumë tesbih duke bërë lehlil dhe tahmid. Sepse këto janë shkak për mbjelljen e Xhennetit. Gjatë kësaj kënaqësie banorët e Xhennetit i merr malli për një lloj tjetër kënaqësi që ka tjetër shije. Kjo është kënaqësia e pirjes prej këtyre lumejve që na ka treguar Allahu për to se ato janë përgëzim për ata që kanë besuar dhe kanë bërë punë të mira.

Allahu i Madhëruar thotë (kuptimi i ajetit):  
**"Përgëzoji ata që kanë kanë besuar dhe kanë bërë punë të mira se për ta ka Xhennete nën të cilat rrjedhin lumenj, sa herë që u jepet një frut thonë si kjo na është dhënë edhe më parë".** (El-Bekare: 25)

Lumenjtë e Xhennetit nuk janë vetëm prej uji por janë edhe prej qumështi vere dhe mjalti të kulluar.

**"Përkrimi i Xhennetit që është përgatitur për të devotshmit është se në të ka lumenj prej uji të pa ndryshuar, lumenj prej qumështi që nuk i ka ndryshuar shija, lumenj prej vere të shijshëm për ata që do t'i pinë dhe lumenj prej mjalti të kulluar".**

Gjithashtu në Xhennet ka burime me pije dhe shije të ndryshme. Si burimi i Kafurit, i Tesnimit, i Selsebilit. A nuk po na merr malli për lumenjtë e Xhennetit, për burimet e tij dhe ushqimet e tij?

Atëherë dëgjoje të përmalluarin se çfarë thotë:

*Pemët e tij janë dy lloje njëri prej tyre është i ngjashëm me atë që ndodhet në dunja.*



*Mjafton për numërimin e tyre fjala e Zotit tonë që çdo frut atje është dy lloje.*

*Besimtari i shijon ato kur i ha siç i shijon edhe syri para ngrënies.*

*Ah sa të mira janë ato fruta të cilat janë mbjellë në kopshte që dheu i tyre është misku.*

*Kështu është edhe uji që pinë (i shijshëm) e sa e mirë është kjo pije për të eturin.*

*Kur të marrësh prej atyre frutave vjen në vend të saj një tjetër si ajo.*

*Nuk ndërpriten kurrë dhe nuk kanë nevojë që të presin diellin kur të vijë koha që të piqen.*

*Gjithashtu nuk u ndalohen dhe as nuk kanë nevojë që të ngjiten mbi to.*

*Por janë të ulëta dhe mund t'i marrësh ato si të dëshirosh në formën më të thjeshtë.*

Ky është malli o vëllezër. Gjithashtu dëgjo se çfarë thotë i përmalluari në përshkrimin e ushqimit dhe pijeve të Xhennetit.

*Ushqimi i tyre është çfarë të dëshirojnë ata dhe mish zogjsh të butë e të shëndoshë.*

*Fruta të shumëllojshme sipas ëndrrave të tyre. Kjo ngopje është për besimtarët.*

*Atje kanë mish, verë, gra, fruta, parfum dhe erëra të këndëshme që vijnë prej luleve.*

*Enët e tyre janë prej ari ua sjellin djelmosha që janë shërbëtorët e tyre.*

*Atyre u jepet të pinë nektar të vulosur me misk fillimi i tij është si fundi i tij.*

*Bashkë me verë të shijshme për atë që e pi por nuk të deh e as nuk është e dëmshme dhe as nuk ka në të ndonjë të metë.*

*Pija e tyre do jetë prej selsebili e përzier me kafur ajo pije është për bamirësit.*

*Ndërsa kjo është pija e të djathtëve. Kurse bamirësit kanë pije tjetër.*

*Quhet tesnim pija e tyre e lartë. Pija e atyre që janë të zgjedhurit e Mëshiruesit.*

Ky është malli o vëllezër për atë vend. O vellezër e ju o motra, banorët e Xhennetit në Xhennet janë si mbretërit në fronet e tyre. Mbi kokat e tyre kanë kurora dhe rrobat e tyre janë prej mëndafshi të hollë të gjelbër e të trashë e poshtë tyre kanë shtresat dhe jastëkët e bukur.

Ndërkohë i merr malli për meloditë e Xhennetit që u ka premtuar Allahu. Për shkak se janë larguar nga muzika e kësaj dunjaje. Po, i merr malli për këndimin e hurijeve për të cilin i ka premtuar Allahu ku thotë (kuptimi i ajetit): "**Ditën që do bëhet Kijameti atë ditë kanë për t`u ndarë. Ata që besua dhe bënë punë të mira në kopshte kanë për t`u kënaqur** (duke dëgjuar)". (Er-Rum: 15) Kështu e ka shpjeguar Ibn Kethiri.

Siç ka premtuar gjithashtu edhe Profeti (sal-lAllahu alejhi ue sel-lem) ku thotë: "**Gratë e Xhennetit i këndojnë burrave të tyre me më të bukurin zë. Nuk e ka dëgjuar atë asnjeri kurrë. Ato thonë në këngët e tyre: Ne jemi të sjellshmet, të bukurat, gratë e njerëzve të mirë. Gjithashtu thonë: Ne jemi të përheshme dhe nuk vdesim, jemi të rejat dhe nuk plakemi dhe jemi të kënaqura dhe nuk zemrëohemi. Jetë të lumtur do bëjë ai që na ka ne dhe që do jetë i yni**".

Gjithashtu ka thënë Profeti (sal-lAllahu alejhi ue sel-lem). Çdo person që hyn në Xhennet i qëndrojnë tek koka dhe tek këmbët dy hurij, i këndojnë me më të bukurin zë që kanë dëgjuar xhindet e njerëzit ndonjeherë. Por jo si fyelli I shejtanit.

A e dëgjove o ti që e do muzikën e dunjasë? O ti që këndon me vete ditë e natë duke thënë fjalë që as vetë nuk i kupton! A e dëgjove o ti që do këngët e këngëtareve që janë prej njerëzve të këqij? A e dëgjove fjalën e Profetit. A nuk u përmallua shpirti yt për këndimine hurjive. Prandaj lere muzikën e dunjasë. Bile lere dunjanë me ç`ka brenda saj me gjithë kënaqësitë dhe epshet që ka në të që të arrish atje. E të dëgjosh ato zëra e ato melodi të cilat nuk i ke dëgjuar kurrë.

Ibn Abbasi ka thënë:

*Zoti ynë dërgon një erë që tund degët e pemëve.*

*Gjë që sjell disa zëra të këndshëm për veshin e njeriut si tingujt melodikë.*

*Prandaj mos e ndërro këtë kënaqësi me kënaqësië e veglave muzikore të dunjasë.*

*A nuk e ke dëgjuar se dëgjimi tyre në të janë këngët e hurijeve me zëra shumë të bukur.*

*Ah çfarë këndimi është ai me të cilin u kënaqën veshët nga mirësia e tij.*

*Ah çfarë këndimi, sa i mirë është ai prej atyre që janë si hëna në degët e pemëve.*

*Ah çfarë këndimi, sa e sa gëzim dhe dashuri sjell ai për zemrën.*

*E ç' mund të thuash për atë që dëgjon më të bukurin zë prej hurijeve të bukura të Xhennetit.*

*Ato thonë: Ne jemi të reja, të përhershme, të sjellshme, me bukuri dhe sjellje të larta.*

*Nuk vdesim as nuk ka frikë (në Xhennet për ne) dhe as nuk urrejmë e as nuk zemërohemi.*

*Jetë të lumtur ka për të bërë ai që do jetë i joni ose do jemi të tij me të drejtë (dy transmetime).*

*Ruaje dëgjimin tënd prej këtyre këngëve të dunjasë nëse dëshiron të dëgjosh ato këngë.*

*Mos i jep përparësi më të ultës dhe të lesh atë që është më e larta se mund t`i humbësh të dyja. E sa poshtëruese është kjo!*

Ky është malli për atë vend. Vëlla i dashur dhe ti o motër e nderuar! Disa njerëz e humbin shpresën se mund të arrijnë në Xhennet. Mbase i thotë shejtani që punët e tua nuk janë të pranuar ose se ti nuk je prej banorëve të Xhennetit. Dije o vëlla dhe ti o motër, se mirësia e Allahut është e gjerë dhe mëshira e Tij ka përfshirë çdo gjë. Prandaj përvishu, merre rrugën seriozisht dhe me vendosmëri duke bërë punë të mira dhe mos e humb shpresën se do do arrish atje. Bëje qëllimin tënd të arrish Firdeusin e Lartë e mos thuaj vetëm të hyj tek dera e tij mjafton. Jo o vëlla, letë jetë malli yt për Xhennetin më I madh.

Nëse dëshiron që të të marrë malli për Xhennetin dhe të jetë malli yt i fortë, dëgjo atëherë për gratë e Xhennetit, bukurinë e tyre dhe kënaqësinë e takimit me to.

Vëlla i dashur, Allahu i Madhëruar i marton banorët e Xhennetit me gra shumë të bukura përveç grave të tyre që kanë pasur në dunja. E megjithatë gruaja e e tij në dunja nëse i bindet atij e është e devotshme, agjëron, fal namaz nate, kujdeset për fëmijët e saj dhe për veten e saj ajo ka për të qënë në gradë më të lartë në Xhennet se hurijet.

Allahu i Madhëruar ka thënë (kuptimi i ajetit): "Të devotshim do jenë në vend banim të sigurt në Xhennete dhe burime, veshin mëndafsh të hollë dhe të trashë të ulur përballë njëri-tjetrit. Gjithashtu i kemi martuar me hurijet". (Ed-Duhan: 51-54) حور është shumësi i fjalës Haura. Është quajtur ashtu sepse i bardhi i syve të saj është shumë i fortë dhe i ziu gjithashtu. Ndërsa عین d.m.th. që i ka sytë të mëdhenj. Allahu i ka përshkruar hurijet me një përshkrim që ta shton mallin më shumë.

Allahu i Madhëruar ka thënë (kuptimi i ajetit): "**Të devotshmit janë fitimtarët. Për ta ka kopshte dhe rrush. Gjithashtu ka për ta edhe gra keuaib në të njëjtën moshë**". (En-Nebe: 31-33) Keuaib është shumësi i fjalës kaib që është gruaja e bukur që i sapo i është shfaqur gjoksi. Dëgjo një përshkrim tjetër që ta shton mallin më shumë për to.

Allahu i Madhëruar ka thënë (kuptimi i ajetit): "**Ne i kemi krijuar ato (ndryshe nga gratë e dunjasë) i kemi krijuar të virgjëra të dashura për burrat e tyre në të njëjtën moshë (të gjitha)**". [El-Uakiah: 35-37]

Të virgjëra d.m.th. që askush nuk i ka prekur ato. Siç ka thënë Allahu i Madhëruar: "**Në të ka gra që e ulin shikimin e tyre. Nuk i ka prekur ato më parë as njeri dhe as xhind. Cilën mirësi të Zotit tuaj po mohoni?! Ato janë**

**sikur me qenë rubinë dhe korale. Cilën mirësi të Zotit tuaj po mohoni?!"** (Er-Rahman: 56-59)

Gjithashtu Allahu i Madhëruar ka thënë (kuptimi i ajetit): **"Në të ka (gra) të sjellshme dhe të bukura. Cilën mirësi të Zotit tuaj po mohoni?1 Hurij të ruajtura në çadra. Cilën mirësi të Zotit tuaj po mohoni?!"** (Er-Rahman: 70-73)

Gjithashtu ato janë të pastra prej menstruacioneve, lehonisë dhe çdo pislëku tjetër. Ato nuk janë si gratë e dunjasë të cilat janë tradhtare, të cilat i urrejnë burrat e tyre, të cilat mallkojnë dhe ofendojnë.

**"Ata kanë në të gra të pastra e në të janë të përhershëm".** (El-Bekare: 25)

Profeti (sal-lAllahu alejhi ue sel-lem) i ka përshkruar hurjiet me një përshkrim që të shtyn të përpiqesh edhe më shumë për të bërë punë të mira që të arrish tek ato. Profeti (sal-lAllahu alejhi ue sel-lem) ka thënë: *"Sikur një prej grave të Xhennetit të dalë në dunja, do e ndriçonte gjithë botën dhe do e mbushte atë me erë të mirë. Shamia që ka ajo në kokë është më e mirë se dunjaja dhe çka brenda saj".*



Gjithashtu Profeti (sal-Allahuejhi ue sel-lem) ka thënë: *"Çdo person në Xhennet ka dy gra prej hurijeve. Çdonjëra prej tyre ka veshur shtatëdhjetë rrobe i duket edhe palca e kërcirit të saj pas rrobave".*

Ka treguar el-Euzai nga Hasan Ibn Atije nga Ibn Mes'udi se ka thënë: "Në Xhennet është një haura që quhet lu'be. Të gjithë hurijet e Xhennetit e pëlqejnë atë shumë, i prekin supin e i thonë: Jetë të lumtur ka ai do të ketë ty. Sikur të të njohin ty, ata që kërkojnë Xhennetin, do e merrnin rrugën me vendosmëri. Në ball e ka të shkruar: Kush dëshiron të ketë një grua si unë le të punojë që të kënaqë Zotin tim".

I ka thënë Ata Es-Sulemi Malik Ibn Dinarit: O Ebu Jahja, na trego diçka që na shton mallin (për Xhennetin), tha: Në Xhennet është një haura, krenohen banorët e Xhennetit me bukurinë e saj. Sikur mos e kishte shkruar Allahu që në Xhennet nuk ka vdekje do vdisnin nga bukuria e saj.

Rabia Ibn Kulthum ka thënë: Na pa Hasen el-Basri që u mblodhëm rreth tij. Ishim djem të rinj dhe na tha: O djema, a nuk ju ka marrë malli për hurijet?!

Ibnul Kajim thotë më tha Ibnu Ebil Haura na ka treguar Hadramiu tha : Fjeta një natë unë me Ebu Hamzen në një vend. Ai tërë natën kthehej sa majtas djathtas deri në mëngjes. I thashë o Ebu Hamze nuk fjete mbrëmë? Tha: Kur u shtriva dje m`u përfytyrua përpara meje një haura aq sa më dukej sikur po e prekja me dorë. I thashë për këtë Ebu Sulejmanit e më tha : Ky qenka person I përmalluar.

Ka treguar Ibnu Ebi Dun'ja nga Salih el-Merri e transmeton nga Zejd Errakashi se ka thënë: Më kanë treguar se në Xhennet vetëtiu një dritë. Nuk ngeli vend në Xhennet pa e përshkuar kjo dritë. Pyesin ç'është kjo? U thuhet : Një haura i qeshi burrit të saj. Salihu tha: Një person në anë të mexhllisit kur e dëgjoi këtë mori frymë thellë derisa vdiq.

Dëgjoje o vëlla historinë e këtij djaloshi! Ka treguar Ibn Ebi Dun'ja nga Ebu Sulejman Ed-Darani se ka thënë: Ishte një djalë nga Iraku adhurues i madh. Doli me një shokun e tij për në Mekë. Kur zbrisnin për t`u qetësuar ai falej kur hanin ai agjëronte. Shoku i tij nuk i foli për këtë gjë derisa u kthyen. E kur deshën të ndahen i tha: Më trego ç'të nxit të bësh gjithë këtë që pashë (rrugës, prej teje). Tha: Pashë në ëndërr një kështjellë prej kështjellave të Xhennetit. Vura re se tullat e saj ishin njëra prej ari dhe tjetra prej argjendi. Ndërsa dritaret ishin njëra prej zeberxhedi (gur i

çmuar ngjyrë jeshile) dhe tjetra prej rubini. E në to kishte hurije me flokë të lëshuara. Kishte veshur një rrobë me fije argjendi. Më tha: Më kërko tek Allahu me seriozitet dhe vendosmëri, se vallahi edhe unë të kam kërkuar tek Ai kështu. Prandaj po i veproj këto që sheh. Ebu Sulejmani tha: Kjo është vetëm për një haura, po ata që kërkojnë më shumë se kaq?! Ky është malli i këtyre njerëzve.

A nuk të mori malli vëlla për Xhennetin dhe për hurijet?!

Dëgjoje të përmalluarin se si i përshkruan hurijet ku thotë:

*Dëgjoje përshkrimin e nuseve të Xhennetit dhe zgjidh për veten tënde atëherë o vëlla.*

*Ato janë hurije të plota në krijim dhe bukuri janë nga më të bukurat gra.*

*U plotësua krijimi i saj dhe bukuria e saj si hëna katërmbëdhjetë.*

*Dielli noton në bukurinë e fytyrës së saj. Ndërsa nata është nën degë (tek flokët e saj të zinj)*

*Shfaqet një vetëtimë kur buzëqesh ajo aq sa ndriçon çdo gjë përreth.*

*Është transmetuar se një vetëtimë shfaqet në Xhennet e pyesin banorët e Xhennetit për të.*

*U thuhet kjo është vetëtimia e e buzëqeshjes së haurasë në Xhennetin e lartë siç e shikoni.*

*Jetë të lumtur ka për të bërë ai që e uth atë gojë. Se tek kjo puthje është arritja e ëndrrave të tij.*

*Trupi saj është i njomë prej ujit të rinisë. E në degët e saj rrjedh ky ujë.*

*Ngaqë uji i mirësisë ishte në trupin e saj prandaj dolën edhe fruta të shumë ngjyshme.*

*Kështu dolën prej kësaj dege trëndafila, (faqet e saj) mollë, (ballin e saj) dhe shegë (gjoksi i saj). Madhështor është Ai që e mbjollti këtë kopsht (me këto pemë e lule të bukura).*

*Ndërsa trupi i saj është si dega e njomë dhe mesatar në gjatësi.*

*Ndërsa kyçet e duarve të saj janë të kulluar dhe të pastra si argjendi.*

*Janë si gjalpi të buta dhe të rrubullakta si guacka prej perle.*

*Ndërsa gjoksi i gjerë qëndron mbi belin e ngushtë. E kanë rrethuar atë dy vithe të plota.*

*Ndërsa marrëdhëniet janë rehatia më e madhe e të dashuruarit. E ai kurrë nuk mërzhitet prej kësaj gjëje.*

*E mbasi mbaron marrëdhëniet ajo kthehet edhe një herë e virgjër siç ishte pa asnjë lloj të mete.*

*Na është transmetuar se ky është preokupimi i tyre që është treguar i pa sqaruar në suren Jasin.*

*Është prokupimi i dhëndërit me nusen e tij pasi ka luajtur me ta malli gjatë gjithë kohës.*

*Pasha Allahun mos e pyet atë për prokupimin që ka ato netë. Se prokupimi i tij është një çështje shumë e madhe.*

Dëgjo o vëlla i dashur gjithashtu të përmalluarin, Ibnul Kajimin, kur e përshekruan erën e haurasë, trupin e saj, ngjyrën e saj, fjalët e saj dhe ledhet që i bën burrit të saj.

*Era e tyre është misku e trupi i tyre është i butë ndërsa ngjyra e tyre është si rubini dhe koralet.*

*Ndërsa fjalët e saj ta marrin mendjen nga melodia që është më e bukur se meloditë e dunjasë.*

*Ajo është shumë tërheqëse me pamjen e saj dhe përkëdhelitë e saj dhe tregohet e dashur me të në çdo kohë.*

*Prandaj edhe i lëviz sytë dhe kokën më shumë kur takohen.*

*Nga butësia mirësjellja dhe fjalët e bukura afruese që i thotë, kështu e kanë shpjeguar dijetarët.*

*Mblidhi forcat për atë që është atje, mbylli sytë dhe bëj durim një orë këtu (në dunja).*

*Vallahi ato që janë këtu (në dunja) nuk janë as sa vlera e thoit të njëjës prej atyre që janë në Xhennet!*

*Mos i jep përparësi asaj që është e ulëta duke lënë më të lartën. Nëse bën këtë ke për të fituar vetëm poshtërim dhe turp (ditën e Gjykimit).*

Dëgjoje gjithashtu përshkrimin e haurasë kur ecën kur vesh rrobot dhe xhevahiret për burrin e saj. Ii përmalluari thotë:

*E kur del e veshur me një pelerinë e përdridhet siç përdridhet ai që ka ardhur në qejf nga pija.*

*Tundet si dega e njomë që ka mbi të trëndafila mollë dhe shegë.*

*Ajo ecën me mburrje e i takon asaj një gjë e tillë në Xhennetin e përhershëm.*

*Ka shërbëtore mbrapa saj e para saj nga ana e djathë dhe e majtë (që e rrethojnë).*

*Derisa kur dalin përballë njëri-tjetrit takohen. A ke parë ndonjëherë kur takohet dielli me hënë.*

*Pyete të dashuruarin a duron dot pa e përqaftuar dhe pa e puthur.*

*Pyete të dashuruarin ku e la durimin e tij në cilën luginë apo në cilin vend.*

*Pyete të dashuruarin si është gjendja e tij kur i janë mbushur sytë dhe veshët me kënaqësi.*

*Pyete të dashuruarin si është jeta e tij kur ata janë shtrirë në krevat vetëm për vetëm.*

*Pyete të dashuruarin si është jeta e tij kur rri me të dashurën e tij në mes të erërave të mira të luleve.*

*U vijnë gotat me nektar me anë të djelmohave që janë si hëna.*

*E marrin gotën njëherë ai dhe një herë e dashura e tij e më pas mbështeten.*

*E përqafojnë njëri-tjetrin. A ke parë ndonjëherë dy të dashuruar kur takohen pas një kohe shumë të gjatë.*

*Nuk ka kush i qorton dhe nuk ka asnjë gjë që ua turbullon jetën e tyre e ata të dy me rroben e dashurisë janë mbështjellë.*

*O ti që je i shkujdesur prej shkakut për të cilin u krijove, zgjohu! U nisën me seriozitet të tjerët ndërsa ti je në gjumë.*

*Ikën shokët e tu dhe të lanë të rrish me ata që janë të kënaqur me fatin e ulët që do mbarojë.*



*E shumica e atyre që shikon kanë ngelur mbrapa. Ti i ndoqe ata e u kënaqe që pjesa jote të jetë asgjëja.*

*Të bëri të pëlqyer vetja jote që të bashkohesh me ata që rrijnë e nuk kanë marrë rrugën (e Xhennetit) dhe i kanë dhënë përparësi rehatisë (në këtë botë).*

*Por do ta marrësh vesh kur të zbulohet perdja se çfarë ke bërë dhe çfarë kishe mundësi të bëje.*

**Ky është malli o vëllezër për Xhennetin.**

O vëllezër, Xhennetin e ka marrë malli për banorët e tij. Po ne a na ka marrë malli për të?! A na ka marrë malli që ta fitojmë atë. Duke qenë të devotshëm duke kryer detyrat dhe duke u larguar prej haramëve.

Profeti (sal-lAllahu alejhi ue sel-lem) ka thënë: *"Xhenneti tha: O Zot, frytet e mija janë të pjekura, lumenjtë e mi rrjedhin e mua më ka marrë malli për banorët e mi prandaj m`i sill sa më shpejt ata".*

Transmetohet nga Enesi (radiAllahu anhu) se Profeti (sal-lAllahu alejhi ue sel-lem) ka thënë: *"Kur të hynë banorët e Xhennetit në Xhennet, do t`i marrë malli vëllezërit për njëri-tjetrin; shkon krevati i njëri tek tjetri e kështu të tjerët deri*

*sa bashkohen të gjithë. I thotë njëri shokut të vet: A e di vëlla kur na ka falur Allahu? I thotë në filan ditë në filan vend, iu lutëm Allahut na i fali gjynahet tona e kjo është siç ka thënë Allahu i Madhëruar: "Do dalin para njëri-tjetrit e do pyesin (kush është shkaku që arritën këtë shpërblim kaq të madh, thonë): Ne ishim më parë në familjet tona të frikësuar. Allahu na bëri mirësi dhe na ruajti nga dënimi i nxehtë. Ne i luteshim Atij më parë. Ai është Mirëbërësi I Mëshirshmi".*

Dëgjojeni o vëllezër historinë e këtij të përmalluari për Xhennetin! Kush të jetë vallë? Ai është Umer Ibn AbdulAzizi, prijësi i besimtarëve. Umer Ibn Abdulaziz thotë: Unë kam një shpirt kërkues. Sa herë që arrij diçka, më kërkon diçka më të mirë. E kur unë e arrita këtë gradë (d.m.th. që u bëra prijës) që s'ka mbi të asnjë gradë, shpirti im kërkoi diçka më të lartë d.m.th. Xhennetin. A e shikoni vendosmërinë dhe mallin që kishte prijësi i besimtarëve Allahu e mëshiroftë!

Erdhi një robëreshë e Umer Ibn Abdulazizit dhe i tregoi se ajo pa në ëndërr sikur ura u vendos sipër Xhehennemit ndërsa Xhehennemi shfrynte. E tregoi se ajo pa ca burra që hipën në urë për të kaluar dhe i mori zjarri. Pastaj i tha: Të pashë ty o prijësi i besimtarëve kur të sollën për të kaluar. Kur e dëgjoji Umeri këtë i ra të fikët dhe ndejti

një farë kohe duke u dridhur. Ndërsa ajo i thoshte: Pasha Allahun, të pashë o prijësi i besimtarëve që shpëtove, të pashë që shpëtove.

*O ti që je i zgjuar, karvani iku i shpejtuar ndërsa ne rrimë ulur e ti çfarë po vepron.*

*A je i kënaqur të ngelesh mbara tyre, të kanë hedhur poshtë ëndrrat dhe të pengon dashuria (e epsheve të dunjasë).*

*Le ta qajë veten e vet ai që ka për ta qarë, si i ikën koha duke e humbur me lojë.*

Ky është malli për Xhennetin vëllezër.

O vëllezër e motra, pasi e përshkruam Xhennetin me një pjesë të mirësisë të tij dijeni se mirësia më e madhe e Xhennetit është shikimi i Allahut të Madhëruar Ditën e Shtesës.

Nëse dëshiron të dish vëlla për ditën e shtesës, për vizitën e Ngadhënyesit – El Aziz – Të Lavdëruarit – El Hamid dhe për shikimin e fytyrës së Tij – që është e pastër nga përngjasimi dhe mohimi – siç shikon diellin në drekë dhe hënën natën e plotë. Siç është transmetuar me hadithe muteuatire nga Profeti (sal-lAllahu alejhi ue sel-lem) të

cilat ndodhen në librat e sahiheve suneneve dhe musnedeve me transmetimin e Xheririt, Suhejbit Enesit, Ebu Hurejres, Ebu Musës dhe Ebu Seidit.

Atëherë dëgjo atë ditë kur të thërrasë një thirrës: O banorë të Xhennetit: Allahu i Madhëruar kërkon prej jush që ta vizitoni prandaj ejani tek kjo vizitë. Thonë: Dëgjuam dhe u bindëm. E shpejtojnë për të shkuar në këtë vizitë. Kur shohin që devetë u janë përgatitur për t'i hipur dhe hipin me të shpejtë. Deri sa kur mbërrijnë tek lugina Efjah e cila është vendi i takimit e mblidhen të gjithë sepse thirrësin e dëgjuan të gjithë. Allahu urdhëron që të vendoset Kursiji i Tij atje. Ndërsa besimtarëve u vendosen karriget e tyre prej drite e prej perle prej zeberxhedi, prej ari e prej argjendi. Ai që ka gradën më të ulët – megjithëse nuk ka të ulët në Xhennet – mbi dunat e miskut. E nuk iu duket se janë më të ulët. Derisa kur të qetësohen të gjithë në vendet e tyre. Thërret një thirrës e thotë: O banorët e Xhennetit, Allahu ju ka dhënë një premtim dhe dëshiron t'ua mbajë atë. Thonë: Ç'qenka ky premtim?! A nuk na i zbardhi fytyrat tona, a nuk na i rëndoi peshoret tona a nuk na futi në Xhennet dhe na shpëtoi prej zjarrit?! Ndërkohë shohin një dritë që ndriçon prej saj Xhenneti. Ngrenë kokat e tyre kur ja, Allahu i Madhëruar ka ardhur sipër tyre. E u thotë : O banorë të Xhennetit: Selamun alejkum. A nuk mund ta kthesh këtë përshëndetje në formën më të mirë?! Ata thonë

"Allahume ente Es-salam ue minke es-salam tebarekte ja Dhel xhelail uel ikram".

Gjëja e parë që dëgjojnë prej Allahut të Madhëruar është se u thotë: Ku janë robërit e Mi që m`u bindën Mua pa më parë, kjo është Dita e Shtesës prandaj më kërkoni. E ata të gjithë i thonë: U kënaqëm o Zoti jonë, prandaj kënaqu edhe Ti prej nesh. Thotë: O banorë të Xhen-netit, Unë sikur të mos isha i kënaqur prej jush nuk ju fusja në Xhennetin Tim. Prandaj më kërkoni se kjo është Dita e Shtesës. Atëherë i thonë : Na e trego fytyrën Tënde. E Allahu i zbulon perdet dhe u shfaqet atyre aq sa i mbulon drita e Tij, saqë sikur mos e kishte shkruar Allahu që nuk kanë për të vdekur do digjeshin nga drita e Tij. Nuk ngelet në atë mexhelis (tubim) askush pa i folur Allahu aq sa i thotë: O filan, a të kujtohet kur ke bërë kështu e kështu. I kujton disa gabime që ka bërë në dunja. I thotë: O Zot, a nuk m`i ke falur ato gjynahe?! I thotë : Po, ti me faljen Time arrite deri në këtë gradë.

Hajde çfarë kënaqësie për ata që arrijnë këtë bisedë. Hajde çfarë kënaqësie është për njerëzit e mire, shikimi i fytyrës së Allahut në Ahiret. Sa turp është për ata që ngelën mbrapa, që e humbën tregtinë (më Allahun):

**"Atë ditë ka fytyra të ndritura Tek Zoti i tyre janë duke shikuar Atë ditë ka fytyra të vrenjtura që kanë frikë se do tu thyhet kurrizi". (El-Kijameh: 24-25)**

*Sa e çuditshme që është ajo lugina e cila është vendtakimi i shtesës për ata që e duan Allahun. Ah sikur të jesh prej atyre që do jenë në atë luginë të përmalluar. Mendoj se ai që është i tillë ka për të fituar.*

*Sa i çuditshëm është gëzimi i atyre që e duan Allahun kur t`u flasë nga lart e tu japë selam.*

*Sa të çuditshëm janë ato shikime që do shohin Allahun haptazi. Pa mund dhe pa u lodhur.*

*Prandaj eja për në Xhennetet e Adnit. Sepse atje janë banesat e tua të para dhe atje janë edhe çadrat.*

*Mirëpo ne na ka rrëmbyer armiku dhe nuk e di a do kthehem dot në atdheun tonë dhe a do shpëtojmë dot.*

*Eja për në Ditën e Shtesës e cila është dita e vizitës së Zotit të Arshit. Është ditë e shënuar.*

*Eja për në luginën Ejjah dheu i saj është prej misku (prej së cilës kundërmon era e miskut prandaj është quajtur kështu).*

*Atje ka karrige prej drite, argjendi, prej ari të kulluar që nuk thyhet.*

*Gjithashtu edhe dunat e miskut janë vend qëndrim për ata që kanë gradë më të ulët se të tjerët.*

*Ndërkohë që ata janë në jetën e tyre të lumtur dhe rrizku u vjen atyre pa mbarim.*

*Kur shohin një dritë që ndriçon anembanë Xhennetet, nuk është iluzion.*

*U shfaqet atyre Zoti i qiejve haptazi, qesh mbi Arshin e Tij dhe u thotë :*

*Selamun alejkum, e dëgjojnë të gjithë selamin e tij me veshët e tyre.*

*U thotë: Më kërkoni çfarë të dëshironi sepse çdo gjë që dëshironi është tek Unë se Unë jam më I Mëshirshmi.*

*I thonë të gjithë: Ne kërkojmë që të kënaqesh prej nesh sepse ti je Ai që i jep të mirat dhe mëshiron.*

*U a jep atë dhe e dëshmojnë këtë gjë të gjithë megjithëse Allahu është më Bujari nuk ka nevojë për dëshmitarë.*

*O ti që e ke shitur këtë (mirësi) me diçka pa vlerë në këtë dunja sikur ti nuk e dike. Por ke për ta marrë vesh.*

*Nëse me të vërtetë nuk e di kjo është fatkeqësi por nëse e di fatkeqësia është më e madhe.*

*I lutemi Allahu o vëllezër që me mirësinë e Tij të na e mundësojë ta shohim Atë.*

*Kur ta shohin besimtarët Allahun e Madhëruar do harrojnë të gjitha kënaqësitë e Xhennetit që u përmenda sepse shikimi i Allahut është kënaqësia më e madhe.*

*Pasha Allahun o vëllezër, sikur mos ishte shikimi i Allahut në Xhennet nuk do ishin të kënaqur plotësisht ata që e njohin Allahun.*

*Kënaqësia më e madhe është kënaqësia e shikimit dhe bisedimit me të në Xhennetet e përhershme.*

*Dënimi më i madh për banorët e zjarrit është mosshikimi i Allahut të Madhëruar.*

*Kur ta shohin besimtarët do i harrojnë të gjitha mirësitë që kanë në Xhennet.*



*E kur të vendosi perden kthehen tek mirësitë e tyre të shumëllojshme.*

*Pasha Allahun, nuk ka në dunja gjë më të bukur sesa të të marrë malli për Mëshiruesin.*

*Sikurse shikimi i Fytyrës së Tij të Madhëruar është kënaqësia më e madhe për njeriun.*

Ky është malli vëllezër për Xhennetin. Pas kësaj kënaqësie, u vjen një re që u hedh shi me rrëmbim por ai nuk është shi prej uji por prej parfumi të pastër. Ndërkohë Allahu i urdhëron që të hyjnë tek tregu që është përgatitur për ta pas takimit me Allahun e Madhëruar.

Ai është një treg që nuk shitet në të e as nuk blihet. Ai nuk është si tregjet e dunjasë të cilat janë vendet më të urryera tek Allahu. Në atë treg ka çfarë të dëshirojë shpirti yt dhe çfarë ta pëlqejë syri yt. Më pas kthehen tek familjet e tyre në çadra dhe dhomat e tyre. E u është shtuar bukura edhe më shumë. I thonë: Pasha Allahun ju është shtuar bukuria. E këta i thonë gjithashtu edhe juve u është shtuar bukuria.

Dëgjoje se çfarë thotë i përmalluari i cili na tregon për atë shi dhe për tregun ku thotë:

*Atëherë i mbulon një re që sjell si shiu me furi.*

*Ndërkohë që ata ishin në dritë kur i mbulon (kjo re), i lartë është Allahu që e ka krijuar ngaqë u kënaq prej tyre.*

*E u hedh shi prej parfumi nuk kanë parë të tillë më parë.*

*Ua shton më shumë bukurinë e kjo është prej dhuratave të Allahut.*

*Ndërsa për tregun thotë:*

*I Madhëruari Thotë: Ngrihuni dhe ejani tek kjo mirësi që kam rezervuar për ju prej kohësh.*

*Vijnë tek një treg që as nuk shitet e as nuk blihet në të por merr prej tij pa çmim.*

*Sa i çuditshëm që është ky treg të cilin e kanë ngritur melaiket e Allahut e ka në të çdo mirësi.*

*Në të ndodhen ato që syri nuk ka parë, veshi nuk i ka dëgjuar.*

*As nuk i ka shkuar ndërmend njeriu që të ketë mundësi t`i shprehë me gojë.*

*Ah çfarë tregu është ky që kush hyn në të i arrin të gjitha kënaqësitë vetëm duke i ëndërruar.*

*Ai quhet tregu i njohjes nuk ka në të zhurma as mashtrime dhe as betime (të kota)*

*O ti që e ke këmbyer këtë treg me tregun ku ka vendosur flamurin shejtani.*

*Sikur ta dije vlerën e atij tregu nuk do anoje nga tregu i humbjes që do zhduket.*

*Kur të kthehen tek familjet e tyre me dhurata të marra nga Mëshiruesi.*

*Do u thonë familjet e tyre mirë se vini ç'është kjo bukuri e re që u është dhënë!!*

*Pasha Allahun ju është shtuar bukuria më shumë se më parë.*

*E ua kthejnë edhe ju pasha Atë që ju ka krijuar ju është shtuar bukuria.*

*Mirëpo na takon kjo gjë se ne ishim në takim me Zotin e Arshit i cili është i kënaqur prej nesh.*

*Ata janë të përmalluar për Ditën e Shtesës më shumë se i dashuri për të dashurin e afërt.*

Ky është malli vëllezër për Xhennetin.

Pas gjithë kësaj mirësie të madhe në Xhennetet e përhershme. A nuk u përmallua shpirti yt për lumturinë, kënaqësinë dhe qetësinë që gjendet atje?! A nuk të mori malli për ato grada të larta?! A nuk u përmallove për ato çadra dhe dhoma poshtë të cilave rrjedhin lumenjtë e shumëllojshëm?! A nuk të mori malli për hurijet?! A nuk të tronditi malli për shikimin e Allahut i cili është kënaqësia më e madhe?! A e harrove që banorët e Xhennetit nuk sëmuren e as nuk vdesin as nuk flenë as nuk kanë strese dhe as mërzi?! A e harrove që vdekja theret mes Xhennetit dhe Zjarrit?! Allahu na ruajt prej Zjarrit!

Atëherë kush është detyra jote o vëlla dhe ti o motër? Detyra është që të përpiqemi sa më shumë të mbjellim në Xhennet. Sepse Xhenneti është i pa mbjellur dhe mbjellja e tij është me anë të tesbihut, tekbitit dhe tahmidit. Ah sa i humbur është ai që nuk ka mbjellë në dunja asgjë. Si të iku mbjella këtu dhe e kërkon atje?! Ah i mjeri ai që nuk mbolli, çfarë mirësie i iku. Ata që i ka shkruar Allahu për Xhennet të cilët janë të devotshëm në këtë dunja i bëjnë tesbih Allahut mëngjes e mbrëmje.

Sepse ata e dinë që vetëm me anë të saj mbillet Xhenneti. Gjithashtu kur të hyjnë në Xhennet i bëjnë tesbih Allahut mëngjes dhe mbrëmje. Të devotshmit nuk mjaftohen vetëm me dhikër por ata agjërojnë, falin namaz nate, kanë besim të fortë bëjnë durim, i mbështeten vetëm Allahut dhe e kanë frikë Atë dhe bëjnë shumë punë të mira me anë të së cilave afrohen tek Allahun. Ata i kanë ngritur gradat e tyre në vendet më të larta të Xhennetit. Po ti vëlla, a nuk do të ngjitesh si ata?! A nuk ke shpirt kërkues për mirësitë e Xhennetit?! A nuk i lutesh Zotit tënd të të fusë në Firdeusin e Lartë. Kush të ndalon nga kjo?! A nuk janë dëshirat, shpirti që urdhëron për të këqija dhe shokët e këqij ata që të ndalojnë?! Kush të ndalon ty të arrish Firdeusin e lartë?! A nuk është dunjaja me epshet dhe kënaqësitë e saj?! A mund të barazohet dunjaja me atë mirësi?! Pyete veten vëlla që ta gjesh përgjigjen, deri kur deri e shtyn teuben dhe kthimin tek Allahu me sinqeritet?! Deri kur të të vijë vdekja papritur e të të gjejë duke e kundërshtuar Allahun?! Vëllezër të kthehemi tek Allahu dhe t'i lutemi Atij të na japë sukses dhe të na mundësi që të qëndrojmë të fortë në rrugën e drejtë që të çon tek mirësitë e mëdha të Xhennetit.

Pas këtij qortimi, vazhdon zemra jotë të jetë e ngurtë, as nuk zbutet e as nuk nënshtrohet?! Pas këtij qortimi sytë e tua akoma nuk kanë lotuar?! Pas këtij qortimi do vazhdosh të bësh gjynahe akoma?!

A nuk të tronditi malli për Xhennetin?!

*O Xhenneti i Mëshiruesit ti nuk je i lirë përkundrazi ti je shumë i shtrenjtë për dembelët.*

*O Xhenneti i Mëshiruesit ty nuk të arrin ndër një mijë vetëm se një.*

*O Xhenneti i Mëshiruesit kush është i meritueshëm për ty veç atyre që janë besimtarë dhe të devotshëm.*

*O Xhenneti i Mëshiruesit tregu yt është i dobët ndër ata që janë të poshtër, të ulët si kafshët.*

*O Xhenneti i Mëshiruesit ku është blerësi (yt) sepse je dhënë me një çmim shumë të lirë.*

*O Xhenneti i Mëshiruesit a ka ndonjë që dëshiron të fejojhet (me hurijet e tua) sepse paja është e mundur të jepet vetëm para vdekjes.*

*O Xhenneti i Mëshiruesit si mund të durojnë ata që të kërkojnë ty duke qënë se janë besimtarë.*

*O Xhenneti i Mëshiruesit sikur mos të ishe i rrethuar me gjëra të vështira për njeriun.*

*Nuk do ngelej njeri pa ardhur e do mbyllej fare vendi i dënimit (Xhehennemit).*

*Mirëpo ai u rrethua me shumë gjëra të vështira që të largohet prej tij ai që do të kotën dhe është i ngathët (në të mira).*

*E ta arrijnë ata që kanë vendosmëri që mbërrin deri tek Zoti i lartë me dëshirën e Mëshiruesit.*

***Prandaj lodhu deri ditën e takimit të parë që të gjesh rehatitë ditën e takimit të dytë.***

## Përmbajtja

Parathënia .....3

Përshkrimi i zjarrit të Xhehennemit  
dhe shkaqet që të çojnë tek ai ..... 9

Malli për Xhennetin ..... 39



